REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC
Nr. Br. No. 01-060-01-56654-24
Nr. i lq. / Br. str. / No. pg.
Data / Datum / Date 29.11.2024
OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC

**REPUBLIKA E KOSOVËS**

REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
**KOMUNA E OBILIQIT**
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

---

**KUVENDI KOMUNAL OBILIQ**
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly of Obiliq

# PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I ARSIMIT 2025-2029

Obiliq, nëntor 2024

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), bazuar në Ligjin nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit nr.03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, Strategjisë së Arsimit 2022-2026 MASHT, Udhëzimet Administrative MASHT, bazuar në nenin 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës nr.-I-34, tëdt.25.04.2016, si dhe nenin 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, nr.-I-95, të dt.29.06.2018, Kuvendi Komunal pas shqyrtimit të kërkesës nr.10-104-02-34952-24, të dt.08.11.2024 nga Drejtoria e Arsimit në mbledhjen e mbajtur me dt.26.11.2024 miratoi:

# PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL TË ARSIMIT 2025-2029

Ky dokument është hartuar me mbështetjen profesionale të Qendrës për Arsim të Kosovës (KEC)

KEC
Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

# Përmbajtja


Lista e shkurtesave ... 4
Përmbledhje ekzekutive ... 5
1. Hyrje ... 6
2. Sfondi ... 7
2.1. Arsimi në Komunën e Obiliqit ... 7
2.2. Analiza e gjendjes ... 9
2.2.1. Gjithëpërfshirja në arsim ... 10
2.2.2. Mësimdhënia dhe të nxënit ... 12
2.2.3. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve ... 12
2.2.4. Udhëheqja dhe menaxhimi ... 13
2.2.5. Mjedisi dhe kultura institucionale ... 14
3. Qasja strategjike ... 15
3.1. Vizioni dhe misioni ... 15
3.2. Objektivat strategjikë dhe masat ... 16
3.2.1. Gjithëpërfshirja në arsim ... 17
3.2.2. Mësimdhënia dhe të nxënit ... 20
3.2.3. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve ... 23
3.2.4. Udhëheqja dhe menaxhimi ... 25
3.2.5. Mjedisi dhe kultura institucionale ... 28
4. Plani i veprimit dhe buxheti ... 31
5. Korniza për monitorimin e PZHKA ... 45
Shtojcë 1: Harta e institucioneve arsimore në Komunën e Obiliqit ... 47
Shtojcë 2: Pjesëmarrësit në procesin e planifikimit ... 48

# Lista e shkurtesave

| | |
|---|---|
| AAP | Arsimi dhe Aftësimi Profesional |
| DKA | Drejtoria Komunale e Arsimit |
| EFH | Edukimi në Fëmijërinë e Hershme |
| EPRBM | Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes së Mësimit |
| FNV | Fëmijë me Nevoja të Veçanta |
| IEA | Institucion Edukativ-Arsimor |
| IPK | Instituti Pedagogjik i Kosovës |
| ISCED | Standardi Ndërkombëtar i Klasifikimit të Arsimit |
| KEC | Qendra për Arsim e Kosovës |
| LAN | Rrjeti Lokal Kompjuterik |
| MASHTI | Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit |
| OJQ | Organizatë Joqeveritare |
| P.N | Paralele e Ndarë |
| PZHKA | Plan Zhvillimor Komunal i Arsimit |
| SA | Strategjia e Arsimit 2022-2026 |
| SHF | Shkollë Fillore |
| SHMFU | Shkollë Fillore dhe e Mesme e Ulët |
| SHML | Shkollë e Mesme e Lartë |
| SHML | Shkollë e Mesme e Lartë Profesionale |
| TIK | Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit |
| UA | Udhëzim Administrativ |

# Përmbledhje ekzekutive

Plani Zhvillimor i Arsimit për Komunën e Obiliqit 2025-2029 u hartua përmes një procesi të strukturuar dhe me pjesëmarrje të gjerë të të gjitha palëve me interes, duke u mbështetur në nevojat reale për zhvillimin e arsimit në komunë, si dhe në Strategjinë e Arsimit 2022-2026, të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Plani Zhvillimor i Arsimit u përqendrua në pesë fusha tematike: 1) Gjithëpërfshirja në arsim; 2) Mësimdhënia dhe të nxënit; 3) Zhvillimi profesional i mësimdhënësve; 4) Udhëheqja dhe menaxhimi; dhe 5) Mjedisi dhe kultura institucionale. Në këto fusha u bë analiza e gjendjes përmes metodës SWOT, si dhe u mblodhën të dhëna që shërbyen për qëllime të planifikimit. Në vijim u formuluan vizioni dhe misioni i Planit Zhvillimor.

**Vizioni:** Komuna e Obiliqit - vend ku çdo qytetar ka qasje të barabartë në arsim cilësor parauniversitar dhe mundësi për zhvillim të vazhdueshëm, duke i kontribuuar ndërtimit të një shoqërie të drejtë, të qëndrueshme dhe të zhvilluar.

**Misioni:** Përmirësimi i cilësisë së arsimit parauniversitar në Komunën e Obiliqit përmes krijimit të një mjedisi mësimor të avancuar, mbështetjes së vazhdueshme për zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe përfshirjes së të gjithë nxënësve në procesin arsimor, duke siguruar transparencë, llogaridhënie dhe infrastrukturë të përshtatshme shkollore

Plani Zhvillimor i Arsimit ka pesë objektiva strategjikë, nga një për secilën fushë tematike:

OS1. Përmirësimi i përfshirjes në edukim dhe arsim për të gjitha grupet shoqërore.

OS2. Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit në të gjitha shkollat e Komunës së Obiliqit përmes sigurimit të burimeve të nevojshme, ofrimit të mbështetjes për të gjithë nxënësit dhe fuqizimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë.

OS3. Rritja e kapaciteteve profesionale të mësimdhënësve në Komunën e Obiliqit për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënit.

OS4. Ngritje e efikasitetit dhe efektivitetit në menaxhim nëpërmjet forcimit të transparencës, llogaridhënies dhe bashkëpunimit.

OS5. Sigurimi i mjediseve shkollore të përshtatshme, të sigurta dhe të pajisura me teknologji sipas normave dhe standardeve që mundësojnë mësim cilësor.

Për secilin objektiv strategjik janë përcaktuar masat që çojnë në arritjen e tij, gjithsej 25 syresh. Plani i veprimit dhe buxheti janë hartuar për gjithë periudhën e zbatimit të Planit Zhvillimor të Arsimit, duke filluar nga viti 2025, përfundimisht me vitin 2029. Vlera e mjeteve të nevojshme nga buxheti komunal për zbatimin e Planit, pa llogaritur shpenzimet operative të zakonshme, kap shumën prej € 4,625,950.

Dokumenti mbyllet me kornizën për monitorimin e PZHKA e cila përcakton metodologjinë për përcjelljen e zbatimit të masave dhe arritjes së objektivave strategjikë gjatë periudhës së zbatimit të PZHKA.

# 1. Hyrje

Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit (PZHKA) për Komunën e Obiliqit, për periudhën 2025-2029, është formuluar si një dokument gjithëpërfshirës dhe thelbësor që udhëheq strategjinë dhe zhvillimin e arsimit lokal. Ky plan synon të ndërtojë mbi sukseset e arritura më parë nga institucionet arsimore të komunës, duke njohur njëkohësisht dhe adresuar sfidat që kanë lindur në një peizazh social dhe politik në ndryshim. Gjithashtu, ky plan përqendrohet në shfrytëzimin e mundësive të reja për të ofruar një arsimim të barabartë, gjithëpërfshirës dhe të cilësisë së lartë, në përputhje me pritjet dhe nevojat e komunitetit.

Procesi i planifikimit u udhëhoq nga Grupi për Planifikim të Arsimit, i krijuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) në Obiliq, dhe u mbështet nga ekspertë të Qendrës për Arsim të Kosovës (KEC). Ky proces karakterizohej nga një angazhim i thellë dhe konsultime të vazhdueshme me palët e interesit, duke u ndarë në pesë faza kryesore:

**Faza përgatitore:** Kryetari i Komunës themeloi Grupin për Planifikim të përbërë nga zyrtarë të Drejtorisë së Arsimit dhe drejtues të institucioneve edukative-arsimore brenda komunës. Grupi i Planifikimit në bashkëpunim me KEC zhvilluan metodologjinë e punës dhe përcaktuan orarin e aktiviteteve për hartimin e PZHKA.

**Faza e Analizës së Gjendjes Aktuale:** Grupi për Planifikim analizoi pesë fusha kyçe për zhvillimin arsimor: Gjithëpërfshirja në arsim, mësimdhënia dhe të nxënit, zhvillimi profesional i mësimdhënësve, udhëheqja dhe menaxhimi, dhe mjedisi dhe kultura institucionale. Më 5 qershor 2024, u organizua një punëtori, ku rreth 20 përfaqësues nga palët e ndryshme diskutuan hollësisht mbi të dhënat e mbledhura dhe ndanë vlerësimet e tyre përmes një analize SWOT. Pastaj, u mblodhën të dhëna statistikore për arsimin në Komunën e Obiliqit dhe u përgatit një pasqyrë e gjendjes aktuale të arsimit në komunë, e cila shërbeu si bazë për fazën e radhës.

**Përcaktimi i Objektivave dhe Masave:** Në një punëtori të mbajtur më 13 qershor 2024, anëtarët e Grupit për Planifikim vendosën objektivat strategjikë dhe masat specifike që do të ndihmonin në realizimin e vizionit dhe misionit të arsimit në komunë. Kjo fazë përfshiu gjithashtu një analizë të rreziqeve dhe një rishikim të thellë të strategjisë ekzistuese, e cila u finalizua më 16 korrik 2024.

**Plani i Veprimit dhe Buxheti:** Më 24 korrik 2024, u zhvillua një punëtori për të hartuar planin e veprimit dhe për të përcaktuar buxhetin e nevojshëm. Ky takim përqendroi diskutimet mbi zbatimin praktik të planit dhe zotimin e resurseve financiare të nevojshme.

**Hartimi i Dokumentit të Planit Zhvillimor:** Në përfundim të procesit, u hartua drafti përfundimtar i Planit Zhvillimor të Arsimit për Komunën e Obiliqit, i cili synon të sigurojë një udhëzim të qartë dhe të strukturuar për të gjithë aktorët dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e tij.

# 2. Sfondi

## *2.1. Arsimi në Komunën e Obiliqit*

Komuna e Obiliqit shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës me një sipërfaqe prej 105 $km^2$ dhe kufizohet me komunën e Prishtinës, Fushë Kosovës, Drenasit, Vushtrrisë dhe Podujevës. Komuna ka gjithsej 21 vendbanime dhe 22,704 banorë[1]. Komuna e Obiliqit ka gjithsej 10 institucione publike amë të arsimit parauniversitar dhe 8 paralele të ndara fizike, si dhe një institucion privat të licencuar të nivelit parashkollor (Tabela 1).

**Tabela 1.** Numri i institucioneve arsimore dhe i vijuesve sipas niveleve në vitin shkollor 2023/24[2]

| Niveli i shkollimit | Të dhëna për institucionet | Numri i fëmijëve/nxënësve të regjistruar |
|---|---|---|
| Edukimi parashkollor (0-5 vjeç) | 1 publik<br>1 privat | 77 në institucionin publike<br>deri në 60 në institucionin privat |
| Edukimi parafillor (5 vjeç) | 6 shkolla amë dhe 6 paralele e ndarë fizike | 243 |
| Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët (6-14 vjeç) | 7 shkolla amë dhe 8 paralele të ndara fizike | 2,810 |
| Arsimi i mesëm i lartë (15-17 vjeç) | 2 shkolla të mesme të larta | 617 |

Në këto institucione mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe. Tabela 2 jep një pasqyrë të institucioneve publike në Komunën e Obiliqit

**Tabela 2.** Nxënësit në institucionet publike – viti shkollor 2023/24

| Shkolla | Statusi | Vendi | Niveli sipas ISCED[3] | Nxënës | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Gj | F |
| Rrita Jonë | Amë | Obiliq | 0 | 77 | 41 |
| Naim Frashëri | Amë | Breznicë | 0,1,2 | 189 | 98 |
| Naim Frashëri \| 1 | P.N | Kozaricë | 0,1,2 | 65 | 33 |
| Abdurrahmon Gërguri | Amë | Dardhishtë | 0,1,2 | 121 | 63 |
| Migjeni | Amë | Siboc | 0,1,2 | 150 | 67 |
| Migjeni \| 2 | P.N | Graboc | 0,1,2 | 36 | 18 |
| Hasan Prishtina | Amë | Milloshevë | 0,1,2 | 575 | 267 |
| Hasan Prishtina \| 1 | P.N | Raskovë | 0,1 | 76 | 34 |
| Fazli Graiçevci | Amë | Hade e Re | 0,1,2 | 28 | 12 |
| Fazli Graiçevci \| 1 | P.N | Lajthishtë | 0,1,2 | 78 | 39 |
| Fazli Graiçevci \| 2 | P.N | Palaj | 0,1,2 | 57 | 32 |
| Pandeli Sotiri | Amë | Obiliq i Vjetër | 0,1,2 | 199 | 98 |
| Pandeli Sotiri \| 1 | P.N | Plemetin | 0,1,2 | 162 | 78 |
| Dr. Ibrahim Rugova | Amë | Obiliq | 0,1,2 | 929 | 467 |

[1] Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë, Rezultatet paraprake, ASK, korrik 2024.
[2] Të dhënat për arsimin parauniversitar janë marrë nga DKA-Obiliq dhe i referohen vitit shkollor 2023/2024
[3] ISCED: 0-Edukimi parashkollor/parafillor, 1- Arsimi fillor, 2- Arsimi i mesëm i ulët, 3 – Arsimi i mesëm i lartë

| Shkolla | Statusi | Vendi | Niveli sipas ISCED[3] | Nxënës | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Gj | F |
| Dr. Ibrahim Rugova \| 1 | P.N | Mazgit i Ulët | 0,1,2 | 156 | 83 |
| Dr. Ibrahim Rugova \| 2 | P.N | Mazgit i Epërm | 0,1,2 | 232 | 112 |
| Ismail Dumoshi | Amë | Obiliq | 3 | 339 | 82 |
| 17 Shkurti | Amë | Obiliq | 3 | 278 | 180 |
| **Gjithsej** | | | | **3,747** | **1,804** |

P.N – Paralele e ndarë fizike

Në Komunën e Obiliqit, përveç nxënësve shqiptarë, mësimin e vijojnë edhe nxënës të komuniteteve të tjera, me përfaqësim më të lartë të komunitetit serb, rom dhe ashkali. Pjesëtarët e komunitetit ashkali kryesisht e vijojnë mësimin në institucionet legjitime të arsimit parauniversitar dhe përbëjnë rreth 5% të numrit të nxënësve në këto institucione. Ndërkaq, pjesëtarët e komunitetit serb dhe rom e vijojnë mësimin në shkollat e "sistemit paralel", të cilat funksionojnë jashtë kornizës ligjore të Republikës së Kosovës. Tabela 3 sjell të dhëna për numrin e nxënësve dhe përbërjen etnike të tyre në këto shkolla.

**Tabela 3.** Shkollat e "sistemit paralel" në Komunën e Obiliqit – viti shkollor 2022/23

| Shkollat serbe | Vendi | Niveli sipas ISCED | Nxënësit | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Serbë | Romë | Gjithsej |
| Milan Rakic | Babimoc | 0,1,2 | 79 | | 79 |
| Dositej Obradovic | Palaj | 0,1,2 | 50 | | 50 |
| Sveti Sava | Plemetin | 0,1,2 | 69 | 193 | 262 |
| Sveti Sava (paralele e ndarë e SHML në Graçanicë) | Plemetin | 3 | 71 | 72 | 143 |
| **Gjithsej** | | | **269** | **265** | **534** |

(Burimi: DKA Obiliq)

Në institucionet publike të Komunës së Obiliqit punojnë gjithsej 302 mësimdhënës, prej të cilëve 9 në nivelin parashkollor, 8 në nivelin parafillor, 228 në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët, dhe 57 janë të punësuar në shkollat e mesme të larta të Komunës. Tabela 4 jep të dhëna për raportin mësimdhënës-nxënës në Komunën e Obiliqit, sipas niveleve arsimore, si dhe krahasimin me të dhënat në nivel të Republikës së Kosovës.

**Tabela 4.** Raporti mësimdhënës-nxënës

| Niveli | Komuna e Obiliqit[4] | Republika e Kosovës[5] |
|---|---|---|
| Parashkollor | 8.6 | 10 |
| Parafillor | 14.2 | 16.8 |
| Fillor dhe i mesëm i ulët | 12.3 | 13.3 |
| I mesëm i lartë | 10.8 | 12.3 |

Si dhe të gjitha komunat e Kosovës, ashtu edhe Komuna e Obiliqit përballet me zvogëlim të vazhdueshëm të numrit të nxënësve. Kjo mund të vërehet nga tabela 5 e cila jep të dhëna për numrin e nxënësve në sektorin publik në pesë vitet e fundit. Zvogëlime vërehen tek numri i nxënësve që regjistrojnë klasën e parë e që mund të ndërlidhet me zvogëlimin e natalitetit. Nga 332 nxënës që kanë regjistruar klasën e parë në vitin shkollor 2019/20, në klasën e pestë kanë arritur 315 (viti shkollor 2023/24) që paraqet një zvogëlim prej 5.1%. Ndërkaq, nga 359 nxënës që kanë regjistruar klasën e

[4] Të dhënat për numrin e nxënësve dhe personelit mësimor janë dhënë nga DKA Obiliq dhe i referohen vitit shkollor 2023/24
[5] Raport vjetor statistikor me tregues arsimorë 2022/23, MASHT, dhjetor 2023.

gjashtë në vitin shkollor 2020/21, në klasën e nëntë kanë arritur 320 syresh (viti shkollor 2023/24) ose 10.9% më pak.

Vitet e fundit vërehet një kalim pothuaj se universal nga klasa e pestë në të gjashtën. Kështu në vitin shkollor 2023/24, vetëm 4 nga 359 nxënës që mbaruan klasën e pestë një vit më herët nuk vazhduan mësimet në klasën e gjashtë brenda Komunës së Obiliqit.

**Tabela 5.** Lëvizja e numrit të nxënësve në pesë vjetët e fundit[6]

| Klasa | 2019/20 | 2020/21 | 2021/22 | 2022/23 | 2023/24 |
|---|---|---|---|---|---|
| Parashkollor | 70 | 62 | 61 | 77 | 77 |
| Parafillor | 276 | 293 | 304 | 261 | 243 |
| Klasa 1 | 332 | 312 | 304 | 331 | 284 |
| Klasa 2 | 365 | 325 | 304 | 307 | 329 |
| Klasa 3 | 331 | 360 | 318 | 297 | 303 |
| Klasa 4 | 343 | 324 | 364 | 324 | 289 |
| Klasa 5 | 367 | 337 | 323 | 359 | 315 |
| Klasa 6 | 320 | 359 | 326 | 318 | 355 |
| Klasa 7 | 356 | 312 | 343 | 310 | 310 |
| Klasa 8 | 309 | 350 | 313 | 337 | 305 |
| Klasa 9 | 358 | 307 | 344 | 293 | 320 |
| Klasa 10 | 252 | 237 | 222 | 225 | 224 |
| Klasa 11 | 240 | 240 | 227 | 199 | 212 |
| Klasa 12 | 241 | 226 | 223 | 204 | 181 |
| **Gjithsej** | **4160** | **4044** | **3976** | **3842** | **3747** |

Në vitin 2023, Komuna e Obiliqit ka në dispozicion 4,055,696 EUR për shpenzime në arsim, prej të cilave 379,000 EUR janë alokuar nga të hyrat vetanake, ndërsa pjesa tjetër nga granti qeveritar[7]. Me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2025-2027, parashihet që Komuna e Obiliqit të merr nga Granti Specifik për Arsimin 3,340,714 EUR në vitin 2025, 3,440,935 EUR në vitin 2026 dhe 3,544,163 EUR në vitin 2027[8].

## 2.2. Analiza e gjendjes

Analiza e gjendjes mbështetet në të dhënat e ofruara nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Obiliq, si dhe në procesin e konsultimeve që u realizua përmes dy takimeve të punës të mbajtura më 28 maj 2024 dhe 5 qershor 2024 në Obiliq. Grupi për Planifikim u pajtua që përqendrimi i Planit Zhvillimor të Arsimit të jetë në pesë fusha:

1. Gjithëpërfshirja në arsim,
2. Mësimdhënia dhe të nxënit,
3. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve,
4. Udhëheqja dhe menaxhimi,
5. Mjedisi dhe kultura institucionale.

Duhet theksuar se fushat 2-5 janë të detyrueshme konform Udhëzimit Administrativ të MASHTI Nr. 23/2016, me ç'rast në fushën 2 është shkrirë edhe fusha "Performanca e nxënësve" për shkak të

[6] Statistikat e arsimit 2019/20-2023/24.
[7] Ligji Nr. 08/L-260 për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024
[8] Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2025-2027.

ndërlidhjes së natyrshme të saj me fushën 2. Ndërkaq, fusha 1 është shtuar nga Grupi Planifikues për t'ia përshtatur kontekstit në Komunën e Obiliqit.

Ekziston një ndërlidhje organike në mes të fushave të përzgjedhura nga Grupi për Planifikim i DKA Obiliq dhe fushave të Strategjisë së Arsimit 2022-2026 (SA) të aprovuar nga Qeveria e Kosovës. Kështu, fusha 1 ("Gjithëpërfshirja në arsim") korrespondon me objektivin strategjik 1 të SA ("Rritje e përfshirjes dhe qasje e barabartë në edukimin në fëmijërinë e hershme"), por edhe me objektivin specifik 2.3 ("Rritja e përfshirjes dhe pjesëmarrjes aktive të nxënësve nga grupet e margjinalizuara përmes krijimit të klimës nxitëse dhe përkrahëse"). Në këtë fushë bëjnë pjesë edhe disa elemente specifike që ndërlidhen me orientimin e nxënësve në arsimin profesional e që korrespondojnë me objektivin strategjik 3 të SA.

Fusha 2 ("Mësimdhënia dhe të nxënit") ka të bëjë me cilësinë e arsimit në nivelin parauniversitar dhe si e tillë është e ndërlidhur me objektivin strategjik 2 të SA ("Ngritja e cilësisë së arsimit parauniversitar përmes konsolidimit të mekanizmave për sigurim të cilësisë dhe ofrimit të mësimdhënies cilësore"). Po me këtë objektiv strategjik ndërlidhet edhe fusha 3 ("Zhvillimi profesional i mësimdhënësve") e cila korrespondon me objektivin specifik 2.8 të SA ("Zbatimi i plotë i sistemit të licencimit të mësimdhënësve dhe shtimi i mundësive për zhvillim dhe avancim profesional të mësimdhënësve bazuar në standardet e mësimdhënies"). Ndërkaq, fusha 4 ("Mjedisi dhe kultura institucionale"), ndërlidhet me objektivin specifik 2.3 ("Sigurimi i mjediseve shkollore të shëndetshme, të sigurta dhe të përshtatshme sipas normave dhe standardeve, që mundësojnë mësim cilësor") dhe objektivin strategjik 5 të SA ("Përdorimi i teknologjisë digjitale për përmirësimin e shërbimeve dhe të cilësisë në arsim, në përputhje me trendet e transformimit digjital").

Pasi anëtarët e Grupit për Planifikim kanë rënë dakord për përmbajtjen e fushave, për secilën prej tyre është bërë analiza SWOT, duke identifikuar sukseset dhe dobësitë e pranishme, si dhe mundësitë dhe rreziqet që mund të paraqiten në të ardhmen.

### 2.2.1. Gjithëpërfshirja në arsim

Në Komunën e Obiliqit funksionon një institucion i specializuar parashkollor publik – "Rrita jonë", ku shërbimet e qëndrimit ditor i shfrytëzojnë 77 fëmijë të moshave 1-5 vjeç. Në Komunën e Obiliqit ekziston edhe një kopsht privat i licencuar me kapacitet prej 60 fëmijë. Me financimin e MASHTI, në f. Milloshevë është duke u ndërtuar çerdhja e re me kapacitet prej 80 vendesh e cila duhet të funksionalizohet në gjysmën e dytë të vitit 2025.

**Sfidat kryesore:**
- Përfshirja e ulët në edukimin

Vitet e fundit është shënuar një avancim i dukshëm në përfshirjen e fëmijëve në klasat parafillore, të cilat operojnë në kuadër të shkollave fillore të komunës. Gjatë vitit shkollor 2022/23 në këtë formë të mësimit kanë qenë të përshirë 261 fëmijë, ndërsa në vitin shkollor 2023/24 – 243 fëmijë. Pritet që nga fillimi i vitit shkollor 2024/25, kur edukimi parafillor të bëhet i obligueshëm, të gjithë fëmijët e moshës 5 vjeç të përfshihen në këtë nivel të shkollimit.

Komuna e Obiliqit ka zbatuar masa stimuluese për të inkurajuar përfshirjen në arsim. Kështu, janë kompensuar shpenzimet e udhëtimit për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta e të larta brenda komunës, si dhe shpenzimet e udhëtimit për nxënësit e shkollave të mesme të larta, të cilët vazhdojnë shkollimin në Prishtinë në mungesë të drejtimeve përkatëse në shkollat e Komunës së Obiliqit.

Për të inkurajuar pjesëmarrjen në arsimin e të rriturve janë liruar nga obligimi i pagesës të gjithë përfituesit e ndihmave sociale, ndërsa është ofruar transport falas për vijuesit nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Në shkollat e komunës janë aktive ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes së shkollimit, dhe, si rezultat i këtyre angazhimeve, është zvogëluar numri i braktisjeve. Në vazhdimësi, ekziston rreziku të shfaqen raste të tilla, sidomos tek pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët jetojnë në gjendje të vështirë ekonomike. Një shkaktar tjetër i braktisjes tek pjesëtarët e këtyre komuniteteve mund të jenë martesat e hershme, problem i cili është duke u adresuar edhe nga niveli qendror në Kosovë. Pa dyshim, një problem i evidentuar tek pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është numri i madh i mungesave i cili mund të bëhet shkaktar i braktisjes në të ardhmen ose i arritjeve akademike më të ulëta sesa te komuniteti shumicë.

Edhe pse janë shënuar rezultate të lakmueshme në përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta, mbetet evident problemi i qasjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara fizike në disa objekte shkollore. Po ashtu, duhet të punohet edhe më tutje në sigurimin e asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta.

Sa i përket profileve të arsimit profesional, në shkollën e mesme profesionale të Komunës aktualisht ofrohen 9 profile, 6 prej të cilave ndërlidhen ngushtë me ekonominë, e cila funksionon brenda komunës: energjetikë, informatikë, gjeologji, xehetari, laborant i kimisë dhe operator i prodhimit. Në këto 6 profile mësimin aktualisht vijojnë 242 nxënës, prej të cilëve 26 vajza. Ndërkaq, në tri profilet tjera që nuk lidhen drejtpërdrejt me ekonominë e komunës – banka dhe financa, kontabilist dhe telekomunikacion – mësimet vijojnë 97 nxënës prej të cilëve 56 vajza. Në dy drejtimet e gjimnazit, mësimet i vijojnë 278 nxënës, prej të cilëve 180 vajza (Tabela 6).

**Tabela 6.** Nxënësit në shkollat e mesme të larta të Komunës së Obiliqit sipas profileve/drejtimeve – viti shkollor 2023/24

| SHML | Profili | 2023/24 | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Klasa 10 | | Klasa 11 | | Klasa 12 | | Gjithsej | |
| | | Gj | F | Gj | F | Gj | F | Gj | F |
| SHMLP "Ismail Dumoshi" | Banka dhe financa | 26 | 13 | 17 | 7 | 33 | 23 | 76 | 43 |
| | Kontabilist | 0 | 0 | 14 | 8 | 0 | 0 | 14 | 8 |
| | Energjetikë | 14 | 0 | 38 | 0 | 24 | 0 | 76 | 0 |
| | Informatikë | 28 | 6 | 28 | 2 | 19 | 0 | 75 | 8 |
| | Telekomunikacionit | 0 | 0 | 0 | 0 | 7 | 5 | 7 | 5 |
| | Gjeolog | 14 | 6 | 0 | 0 | 0 | 0 | 14 | 6 |
| | Xehetar | 13 | 0 | 16 | 0 | 0 | 0 | 29 | 0 |
| | Laborant i kimisë | 13 | 5 | 0 | 0 | 10 | 7 | 23 | 12 |
| | Operator i prodhimit | 14 | 0 | 0 | 0 | 11 | 0 | 25 | 0 |
| | *Gjithsej* | *122* | *30* | *113* | *17* | *104* | *35* | *339* | *82* |
| Gjimnazi "17 Shkurti" | Shoqëror | 35 | 26 | 51 | 33 | 27 | 19 | 113 | 78 |
| | Shkenca Natyrore | 67 | 37 | 48 | 30 | 50 | 35 | 165 | 102 |
| | *Gjithsej* | *102* | *63* | *99* | *63* | *77* | *54* | *278* | *180* |
| **Gjithsej SHML Obiliq** | | **224** | **93** | **212** | **80** | **181** | **89** | **617** | **262** |

(Burimi: DKA-Obiliq)

### 2.2.2. Mësimdhënia dhe të nxënit

Zbatimi i Kurrikulës së re të bazuar në kompetenca paraqet sfidë në gjithë Kosovën dhe Komuna e Obiliqit nuk përbën përjashtim. Mbështetja për zbatimin e kësaj Kurrikule nga niveli qendror është kufizuar në disa trajnime fillestare, pa aktivitete përcjellëse dhe këshilluese. Përkundër kësaj, është arritur që në shkollat e Obiliqit të zbatohet kurrikula me zgjedhje. Po ashtu, janë plotësisht funksionale aktivet profesionale në shkolla, por mungon një mekanizëm koordinues në mes tyre në nivel të komunës. Si masë stimuluese, Komuna ka ndarë bursa për të gjithë nxënësit e shkëlqyeshëm të shkollave të mesme të larta. Po ashtu, i është kushtuar kujdes plotësimit të personelit të shkollave me bashkëpunëtorë profesionalë. Vitet e fundit janë punësuar 3 psikologë, 1 logoped dhe 7 asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta.

> **Sfidat kryesore:**
> - Mjete të pamjaftuesh me të konkretizimit

Komuna ka investuar mjaft në kabinete mësimore për shkollat e mesme të ulëta dhe të larta. Një ndër sfidat kryesore me të cilat përballen shkollat në Komunën e Obiliqit është mungesa e mjeteve të konkretizimit në nivelin e arsimit fillor. Kjo vlen edhe për shkollat profesionale, të cilat nuk kanë mjete adekuate për realizimin e punës praktike në shkollë, ndërkohë që asnjëri nga profilet nuk është përfshirë në projektin e mësimit dual që udhëhiqet nga MASHTI. Megjithatë, ekziston një interesim në rritje i kompanive brenda komunës për të bërë të mundur praktikën profesionale të nxënësve të shkollës profesionale.

Një problematikë aktuale ndërlidhet me kapacitetin e DKA për të ofruar mbështetje për shkollat. Me numër të vogël të zyrtarëve për arsim, kjo Drejtori nuk ia del të bëjë koordinimin e aktiveve profesionale ose të koordinatorëve të cilësisë në nivelin komunal. Për më tepër, shumë koordinatorë, të cilësisë kanë mbetur pa i përfunduar trajnimet, pasi viteve të fundit ato nuk ofrohen nga MASHTI.

Një çështje tjetër që ndërlidhet me cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënit janë shkollat me pak nxënës, brenda të cilave funksionojnë paralele të vogla ose të kombinuara, ku mësojnë bashkë nxënësit e disa grupmoshave. Në Komunën e Obiliqit janë një shkollë amë dhe një paralele e ndarë me më pak se 50 nxënës.

Si në gjithë vendin, ashtu edhe në Komunën e Obiliqit mundësitë për të zhvilluar aktivitete shtesë me nxënësit që ngecin në mësime dhe nxënësit me prirje të veçanta janë shumë të kufizuara. Kjo për shkak të çështjeve organizative dhe normative që ndërlidhen me mënyrën e organizimit të procesit mësimor dhe kontratat e personelit mësimor.

### 2.2.3. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve

Personelin mësimor të sektorit publik në Komunën e Obiliqit e përbëjnë 326 persona. Bëhet fjalë për kuadër mësimor të kualifikuar dhe, në përgjithësi të interesuar për zhvillim profesional. Duke ju përgjigjur obligimeve që përcakton legjislacioni në fuqi, Komuna e Obiliqit ka ndarë 16,300 € për zhvillimin profesional të mësimdhënësve gjatë vitit 2024,pra 50 € për mësimdhënës. Komuna nuk ka bërë ndonjë analizë të nevojave për trajnime, por personeli mësimor përfshihet në trajnime ad-hoc, varësisht nga mundësitë që ofrohen prej projekteve të financuara nga donatorët. Projektet e tilla janë të pakta në numër dhe jo medoemos ofrojnë programe të cilat janë të nevojshme për mësimdhënës. Po ashtu, nuk janë të shumta mundësitë për organizimin e zhvillimit profesional me bazë në shkollë, si dhe rastet e shkëmbimit të përvojave në mes të shkollave.

**Sfidat kryesore:**

- Mungesa e analizës së nevojave për

Pamundësia e komunës që të ofrojë zhvillim profesional mund të sjellë deri tek ngecja në avancim për shkak të pamundësisë së mësimdhënësve për t'i plotësuar kërkesat e licencimit. Nga ana tjetër, ekziston rreziku që, për qëllime të përmbushjes së kritereve për licencim, për mësimdhënës të replikohen trajnimet e njëjta, duke krijuar kështu uniformitet të padëshirueshëm në procesin e mësimdhënies. Po ashtu, duhet siguruar që njohuritë e përfituara në trajnime të zbatohen në procesin mësimor, duke ndikuar në ngritjen e cilësisë së arsimit.

## 2.2.4. Udhëheqja dhe menaxhimi

Në Komunën e Obiliqit, procesi i udhëheqjes dhe menaxhimit në institucionet edukative-arsimore karakterizohet nga përpjekjet për të mbajtur standarde të larta të transparencës dhe përgjegjësisë. Drejtoria Komunale e Arsimit në Obiliq zbaton vlerësimet e performancës së drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave, duke ndjekur rregullat e Shërbimit Publik të Kosovës. Ky angazhim për llogaridhënie dhe përgjegjësi reflekton një dëshirë për të përmirësuar vazhdimisht cilësinë e edukimit në komunë.

**Sfidat kryesore:**

- Formalizmi në funksionimin

Megjithatë, një sfidë konsistente në udhëheqjen dhe menaxhimin e shkollave në Obiliq është formalizmi i theksuar në funksionimin e këshillave drejtuese të shkollave, i cili vërehet si problem edhe në nivele më të larta. Në disa raste, këshillat drejtuese nuk janë funksionale, çka përbën një kundërshtim të qartë me parimet e qeverisjes së mirë dhe llogaridhënies.

Drejtuesit aktualë të institucioneve arsimore i kanë të përfunduara trajnimet për udhëheqje arsimore. Trajnimet për udhëheqje arsimore janë të kufizuara, çka mund të kufizojë mundësitë për zhvillim profesional të drejtuesve të arsimit dhe të zvogëlojë konkurrencën për pozicione udhëheqëse në të ardhmen. Faktorë tjerë që ndikojnë në mungesën e interesimit për poste menaxheriale në arsim janë kompetencat e kufizuara të drejtorëve të shkollave si pasojë e mungesës së autonomisë së shkollës, ngarkesa e tyre me punë administrative dhe mandatet e kufizuara në poste udhëheqëse.

Numri i vogël i zyrtarëve në Drejtorinë Komunale të Arsimit gjithashtu e bën të vështirë monitorimin e efektivitetit të shumë institucioneve edukativo-arsimore, duke ndikuar negativisht në aftësinë e DKA-së për të mbikëqyrur dhe mbështetur shkollat efektivisht.

Interesimi i komunitetit, bizneseve lokale dhe organizatave joqeveritare për bashkëpunim me shkollat ofron një mundësi të artë për të rritur burimet dhe për të përmirësuar kushtet për zhvillimin e procesit

mësimor. Shkollat në Komunën e Obiliqit kanë shënuar suksese në fitimin e projekteve dhe sigurimin e donacioneve, falë bashkëpunimit të ngushtë me DKA, komunitetin, OJQ-të dhe bizneset. Institucionet arsimore duhet të shfrytëzojnë këtë potencial për të rritur bashkëpunimin dhe për të ndërtuar partneritete që do të ndikojnë pozitivisht në cilësinë e edukimit.

### 2.2.5. Mjedisi dhe kultura institucionale

Në Komunën e Obiliqit, mjedisi dhe kultura institucionale janë fusha të rëndësishme që ndikojnë direkt në cilësinë e procesit arsimor dhe mirëqenien e nxënësve dhe stafit. Fokusi është në përmirësimin e infrastrukturës shkollore, krijimin e hapësirave të gjelbërta, pasurimin e bibliotekave dhe rritjen e sigurisë në shkolla.

**Sfidat kryesore:**

- Mungesa e hapësirave dhe ashensorëve

Në vitet e fundit, është bërë një progres i rëndësishëm në përmirësimin e infrastrukturës shkollore. Shkollat janë pajisur me kabinete të shkencave dhe teknologjisë, dhe janë bërë përmirësime në kushtet e punës në shkollat amë. Një investim i veçantë është bërë për krijimin e infrastrukturës për shkollën e mesme profesionale dhe për digjitalizimin e shkollave me një buxhet prej 200,000 EUR. Megjithatë, ka ende sfida të konsiderueshme, duke përfshirë mungesën e hapësirave në disa paralele të ndara dhe mungesën e ashensorëve në disa shkolla. Kështu, nxënësve në Komunën e Obiliqit ju qëndrojnë në dispozicion 27,478 m2 të ndërtesave shkollore ose, mesatarisht, 7.33 m2 për nxënës (Tabela 6). Po ashtu, shumica e objekteve shkollore punojnë në një ndërrim.

**Tabela 6.** Infrastruktura e shkollave në Komunën e Obiliqit

| Shkolla | Tipi | Numri i nxënësve | Numri i ndërrimeve | m2 | Numri i dhomave (klasave) të mësimit | Numri i kompjuterave |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Rrita Jonë | Amë | 77 | 1 | 730 | 6 | 2 |
| Naim Frashëri | Amë | 189 | 1 | 892 | 12 | 30 |
| Naim Frashëri \| 1 | P.N | 65 | 2 | 270 | 5 | 0 |
| Abdurrahmon Gërguri | Amë | 121 | 2 | 270 | 5 | 8 |
| Migjeni | Amë | 150 | 1 | 764 | 10 | 20 |
| Migjeni \| 2 | P.N | 36 | 2 | 350 | 5 | 5 |
| Hasan Prishtina | Amë | 575 | 1 | 4,900 | 32 | 18 |
| Hasan Prishtina \| 1 | P.N | 76 | 1 | 1,000 | 6 | 0 |
| Fazli Graiçevci | Amë | 28 | 1 | 650 | 8 | 9 |
| Fazli Graiçevci \| 1 | P.N | 78 | 2 | 149 | 5 | 1 |
| Fazli Graiçevci \| 2 | P.N | 57 | 2 | 300 | 5 | 6 |
| Pandeli Sotiri | Amë | 199 | 1 | 3,400 | 9 | 21 |
| Pandeli Sotiri \| 1 | P.N | 162 | 2 | 430 | 5 | 2 |
| Dr. Ibrahim Rugova | Amë | 929 | 2 | 5,268 | 20 | 20 |
| Dr. Ibrahim Rugova \| 1 | P.N | 156 | 2 | 586 | 10 | 1 |
| Dr. Ibrahim Rugova \| 2 | P.N | 232 | 1 | 407 | 6 | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ismail Dumoshi | Amë | 339 | 1 | 4,412 | 24 | 96 |
| 17 Shkurti | Amë | 278 | 1 | 2,700 | 10 | 27 |
| **Gjithsej** | | **3747** | | **27,478** | **183** | **266** |

(Burimi: DKA-Obiliq)

Ndërsa ka pasur investime në pajisjet e TIK, ato nuk i plotësojnë nevojat e të gjitha shkollave, siç mund të shihet edhe nga tabela 6. Kështu në SHMLP "Ismail Dumoshi" është në dispozicion një kompjuter për më pak se 4 nxënës, por në shkollat tjera ndodhë që të jetë vetëm një kompjuter funksional. Në çdo situatë, mirëmbajtja e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit mbetet një sfidë për shkak të mungesës së stafit të specializuar. Aktualisht, është hapur konkursi për një IT për të gjithë shkollat, gjë që është e pamjaftueshme për të përmbushur nevojat e tyre. Qasja në internet dhe shfrytëzimi i burimeve online për mësimdhënie është një fushë me mundësi të mëdha për përmirësim. Disa shkolla përballen me problemin e pagesës së internetit, ku kjo barrë bie mbi stafin shkollor.

Siguria në shkolla është përmirësuar ndjeshëm përmes bashkëpunimit me prindër, bashkëpunimit me policinë dhe vendosjes së kamerave të sigurisë në të gjitha shkollat, përveç në Hade të Re. Zvogëlimi i rasteve të dhunës dhe bullizmit është një tjetër sukses i rëndësishëm që ka ndikuar pozitivisht në atmosferën e përgjithshme në shkolla.

Rregullimi i hapësirave të gjelbërta është një ndër sukseset e rëndësishme, duke kontribuuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të këndshëm për nxënësit dhe stafin. Këto hapësira janë esenciale për aktivitete jashtëshkollore dhe për relaksimin e nxënësve gjatë pushimeve. Këto përpjekje mund të përplotësohen me aktivitet të organizuara të ndërgjegjësimit për ruajtjen e mjedisit.

Furnizimi i bibliotekave shkollore mbetet një sfidë, me gjithë faktin se në vitin 2023 janë investuar 20,000 euro për këtë qëllim. Bibliotekat luajnë një rol kyç në zhvillimin e aftësive lexuese dhe kërkimore të nxënësve, dhe për këtë arsye, është e nevojshme të investohet në pasurimin e tyre me materiale të reja dhe relevante.

Si dhe shumica e komunave të Kosovës, edhe Komuna e Obiliqit përballet me tkurrje demografike e cila rezulton me zvogëlimin e vazhdueshëm të numrit të nxënësve në shkolla, sidomos në zonat rurale ku funksionojnë paralelet e ndara. Meqë trende të tilla priten edhe në të ardhmen është e nevojshme të mendohet për rrjetin e shkollave brenda komunës dhe nevojat infrastrukturore të këtij rrjeti.

# 3. Qasja strategjike

## *3.1. Vizioni dhe misioni*

Vizioni është pasqyrim i gjendjes që duam ta shohim në mjedisin ku jetojmë, pra në Komunën e Obiliqit. Si i tillë, vizioni nuk i referohet vetëm sistemit të arsimit, por situatës së dëshiruar që ndikohet nga sistemi i arsimit. Ndërkaq, misioni është obligimi që merr komuna për arritjen e vizionit dhe përqendrohet në fushën e arsimit. Duke u nisur nga ky këndvështrim, Grupi i Planifikimit ka formuluar vizionin dhe misionin e Planit Zhvillimor Komunal të Arsimit

**Vizioni:**
Komuna e Obiliqit - vend ku çdo qytetar ka qasje të barabartë në arsim cilësor

**Misioni:**
Përmirësimi i cilësisë së arsimit parauniversitar në Komunën e Obiliqit përmes krijimit të një mjedisi

| | |
|---|---|
| parauniversitar dhe mundësi për zhvillim të vazhdueshëm, duke i kontribuuar ndërtimit të një shoqërie të drejtë, të qëndrueshme dhe të zhvilluar | mësimor të avancuar, mbështetjes së vazhdueshme për zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe përfshirjes së të gjithë nxënësve në procesin arsimor, duke siguruar transparencë, llogaridhënie dhe infrastrukturë të përshtatshme shkollore |

Vizioni dhe misioni i Komunës së Obiliqit janë të lidhura ngushtë, duke pasqyruar një aspiratë të qartë për të ndërtuar një shoqëri të përfshirë dhe të zhvilluar nëpërmjet arsimit. Vizioni synon të krijojë një ambient ku çdo qytetar ka qasje të barabartë në arsim cilësor parauniversitar, që është themeli për zhvillimin personal dhe profesional të individëve dhe, në mënyrë më të gjerë, për progresin shoqëror. Kjo pasqyron një angazhim ndaj përmirësimit të jetës së qytetarëve përmes edukimit dhe mundësive të vazhdueshme për të mësuar dhe për të kontribuuar në shoqëri.

Misioni konkretizon këtë vizion përmes theksimit në përmirësimin e cilësisë së arsimit parauniversitar. Krijimi i një mjedisi mësimor të avancuar nuk është thjesht një çështje e pajisjeve dhe infrastrukturës, por përfshin një qasje të tërë për të përfshirë teknologjinë dhe metodat mësimore që përshtaten me nevojat e ndryshme të nxënësve. Ky mjedis mësimor synon të jetë inkurajues dhe stimulues, i cili jo vetëm që mbështet të nxënit tradicional por gjithashtu edukon nxënësit për të qenë krijues dhe të përgjegjshëm ndaj nevojave të shoqërisë.

Mbështetja e vazhdueshme për zhvillimin profesional të mësimdhënësve është një tjetër shtyllë kryesore e misionit. Nëpërmjet trajnimeve dhe mundësive për të mësuar vazhdimisht, mësimdhënësit janë më të pajisur për të përcjellë njohuri dhe për të inkurajuar kritikën dhe mendimin kreativ tek nxënësit. Kjo përgatitje e mësimdhënësve kontribuon direkt në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe, rrjedhimisht, në realizimin e vizionit për arsim cilësor për të gjithë.

Përfshirja e të gjithë nxënësve në procesin arsimor është një aspekt thelbësor për të garantuar që asnjë studentë nuk lihet pas. Kjo përfshirje siguron që çdo nxënës, pavarësisht sfidave individuale—qoftë ato ekonomike, sociale, fizike apo mendore—të ketë mundësinë të arrijë potencialin e tij. Ky angazhim për përfshirje gjithëpërfshirëse është në përputhje të drejtpërdrejtë me vizionin për një shoqëri të drejtë dhe të barabartë.

Në fund, theksi në transparencë dhe llogaridhënie në menaxhimin e arsimit paraqet një angazhim për qeverisje të mirë dhe menaxhim efektiv të resurseve. Kjo shton besimin e komunitetit në sistem dhe siguron që investimet në arsim të kenë impaktin më të madh të mundshëm, duke u përputhur me qëllimin e vizionit për ndërtimin e një shoqërie të zhvilluar.

## *3.2. Objektivat strategjikë dhe masat*

Plani Zhvillimor i Arsimit 2025-2029 ka pesë objektiva strategjikë, nga një për secilën fushë të analizës, siç është prezantuar në tabelën e mëposhtme.

| Fusha | Objektivi strategjik |
|---|---|
| 1. Gjithëpërfshirja në arsim | OS1. Përmirësimi i përfshirjes në edukim dhe arsim për të gjitha grupet shoqërore |
| 2. Mësimdhënia dhe të nxënit | OS2. Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit në të |

| | |
|---|---|
| | gjitha shkollat e Komunës së Obiliqit përmes sigurimit të burimeve të nevojshme, ofrimit të mbështetjes për të gjithë nxënësit dhe fuqizimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë |
| 3. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve | OS3. Rritja e kapaciteteve profesionale të mësimdhënësve në Komunën e Obiliqit për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënit |
| 4. Udhëheqja dhe menaxhimi | OS4. Ngritje e efikasitetit dhe efektivitetit në menaxhim nëpërmjet forcimit të transparencës, llogaridhënies dhe bashkëpunimit |
| 5. Mjedisi dhe kultura institucionale | OS5. Sigurimi i mjediseve shkollore të përshtatshme, të sigurta dhe të pajisura me teknologji sipas normave dhe standardeve që mundësojnë mësim cilësor |

Pra, objektivat strategjikë burojnë nga analiza e gjendjes e prezantuar në kapitullin 2 të këtij dokumenti. Nga ana tjetër, ata janë në përputhje me objektivat strategjikë të definuara në Strategjinë e Arsimit 2022-2026 siç është shpjeguar në seksionin 2.2.

Secili nga këta objektiva nuk vepron në izolim, por është thelbësor për mbështetjen dhe realizimin e objektivave të tjerë, duke krijuar një rrjet të ndërvarur që forcon dhe avancon cilësinë e përgjithshme të arsimit. Për shembull, Objektivi Strategjik 1, që synon përmirësimin e përfshirjes në edukim dhe arsim për të gjitha grupet shoqërore, lidhet ngushtë me Objektivin Strategjik 2 që rrjedh nga nevoja për të siguruar që çdo nxënës, pavarësisht prejardhjes së tij, të ketë qasje në burime të mjaftueshme dhe mbështetje për një mësimdhënie cilësore. Kjo përfshirje e gjerë ndikon drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies, pasi një komunitet më i përfshirë dhe i mbështetur është më i gatshëm të angazhohet dhe të kontribuojë në procesin mësimor.

Nga ana tjetër, Objektivi Strategjik 4, që fokusohet në efikasitetin e menaxhimit, është i rëndësishëm për të mbështetur infrastrukturën e nevojshme për të arritur Objektivin Strategjik 5, sepse siguron menaxhimin efektiv të resurseve, duke krijuar një mjedis arsimor që nxit mësimdhënie dhe të nxënit cilësore.

Secili objektiv strategjik është zbërthyer në masa që janë veprimtaritë e domosdoshme për arritjen e objektivit. Janë gjithsej 24 masa të ndryshme që janë elaboruar në vijim.

### 3.2.1. Gjithëpërfshirja në arsim

**Objektivi Strategjik 1.** Përmirësimi i përfshirjes në edukim dhe arsim për të gjitha grupet shoqërore

Gjithëpërfshirja në arsim nënkupton krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë individët, pavarësisht prejardhjes së tyre sociale, etnike, ekonomike apo aftësive të tyre fizike dhe mendore. Ky objektiv synon të sigurojë që të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në Komunën e Obiliqit të kenë qasje të barabartë në edukim cilësor, duke adresuar barrierat që pengojnë përfshirjen e tyre të plotë në sistemin arsimor.

Për të arritur këtë objektiv, janë të nevojshme masa të ndryshme që synojnë të rrisin përfshirjen në edukimin në fëmijërinë e hershme (EFH), të përmirësojnë përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin arsimor, dhe të krijojnë kushte më të mira për fëmijët me nevoja të veçanta (FNV). Këto masa do të kontribuojnë në zvogëlimin e braktisjes së shkollës dhe do të sigurojnë që çdo fëmijë të ketë mundësinë të arrijë potencialin e tij të plotë.

**Masat**

**1.1. Rritja e përfshirjes në EFH**

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vitin 2022 ka pasur 398 lindje, ku nëna e ka vendbanimin e përhershëm në Komunën e Obiliqit. Duke marrë parasysh shpërnguljet dhe regjistrimin e nxënësve në klasën parafillore dhe në klasën e parë, mund të supozohet se secila grupmoshë nga 1-4 vjeç do të ketë prej 250-300 fëmijë që kanë nevojë për shërbime të edukimit parashkollor, ose gjithsej, në mes të 1,000 dhe 1,200 fëmijë.

Aktualisht, janë duke u zhvilluar punime në kopshtin e fshatit Mazgit me kapacitet prej 120 fëmijësh, të cilat pritet të përfundojnë gjatë vitit 2024. Po ashtu, është në proces ndërtimi një kopshti me kapacitet prej 80 fëmijësh në Milloshevë, i cili duhet të përfundojë gjatë vitit 2025. Komuna e Obiliqit ka bërë kërkesë për ndërtimin e një kopshti tjetër brenda qytetit[9]. Një llogaritje e thjeshtë tregon se, nëse realizohen të gjitha planet për ndërtimin e kopshteve publike dhe duke përfshirë kopshtin ekzistues "Rrita Jonë", Komuna e Obiliqit do të ketë kapacitet për akomodimin e rreth 400 fëmijëve në sektorin publik. Ndërkohë, në sektorin privat operon vetëm një kopsht me kapacitet prej 40 fëmijësh.

Meqenëse 200 vende janë planifikuar në zona rurale ku nuk ekziston tradita e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor, është e nevojshme që Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) të organizojë fushatë sensibilizimi për regjistrimin e fëmijëve në këtë nivel të sistemit arsimor. Grupi i synuar i fushatave të tilla janë prindërit, kryesisht të moshës së re, ndërsa mbështetje mund të kërkohet nga organizatat e shoqërisë civile dhe MASHTI, të cilët tanimë kanë realizuar fushata të tilla.

Një mundësi tjetër është subvencionimi i regjistrimit të fëmijëve në kopshtet private, që mund të nxisë zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja.

Në Komunën e Obiliqit ekziston një praktikë e organizimit të formave alternative të edukimit në fëmijërinë e hershme, kryesisht në vendbanimet, ku ka përqendrim më të madh të komuniteteve rom dhe ashkali. Këto forma alternative konsistojnë në qëndrime më të shkurtra në klasat parashkollore, ku me fëmijët zhvillohet një program i mirëplanifikuar. Format e tilla mund të realizohen në ndërtesat shkollore ekzistuese, duke adaptuar klasa, të cilat nuk shfrytëzohen, fillimisht për fëmijët e moshës 4 vjeç, pastaj edhe për ata të moshës 3 vjeç.

**1.2. Përmirësimi i përfshirjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin e arsimit**

Mungesa e mbështetjes familjare, gjendja e vështirë ekonomike dhe performanca e ulët akademike janë ndër shkaqet kryesore të braktisjes së shkollimit për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në Komunën e Obiliqit, shumë nxënës romë ndjekin mësimin në shkollat e "sistemit paralel" serb për shkak të ndihmave sociale që ofron shteti serb. Për të adresuar këtë sfidë, është thelbësore të

[9] Në Planin Zhvillimor të Komunës parashihet edhe ndërtimi i dy objekteve për edukimin në fëmijërinë e hershme – një në fshatin Dardhishtë dhe tjetri në Palaj ose Lajthishtë, por, deri në momentin e hartimit të PZHKA nuk ka një vendim për fillimin e ndërtimit.

përmirësohet komunikimi me Qendrën për Punë Sociale, për të siguruar që familjet e këtyre komuniteteve të përfitojnë nga skemat sociale të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, është e rëndësishme të zhvillohen aktivitete të vetëdijesimit për prindërit, me qëllim që të sigurohet vijimi i rregullt i shkollimit për fëmijët e komuniteteve. Këto aktivitete mund të realizohen përmes takimeve të rregullta me prindërit e komuniteteve, dhe në raste të veçanta, është e nevojshme të ndërhyhet direkt për të adresuar rastet ku rrezikohet braktisja e shkollimit nga ndonjë fëmijë. Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes së Mësimit (EPRBM) në shkolla duhet të reagojnë shpejt ndaj sinjaleve të kësaj natyre dhe të vendosin kontakt me familjen në momentin e duhur.

Duke qenë se nxënësit e komunitetit ashkali janë kryesisht të përqendruar në fshatin Plemetin, ku funksionon një qendër mësimore e menaxhuar nga organizata të shoqërisë civile, është thelbësore të vendoset komunikim i drejtpërdrejtë me këto organizata, duke shqyrtuar mundësinë për mbështetjen e punës së tyre. Gjithashtu, duhet të merret në konsideratë përkrahja për nismat që vijnë nga vetë komuniteti dhe që synojnë përmirësimin e pozitës së kësaj kategorie të nxënësve në arsim.

### 1.3. Përmirësimi i kushteve të punës për FNV

Përmirësimi i kushteve të punës për fëmijët me nevoja të veçanta (FNV) nënkupton krijimin e parakushteve infrastrukturore dhe pajisjeve të nevojshme për një mjedis mësimor gjithëpërfshirës dhe efektiv. Përveç ndërtimit të pjerrinave për sigurimin e qasjes në shkolla për fëmijët me aftësi të kufizuara fizike, kjo sipërmarrje kërkon furnizimin e shkollave me mjete të specializuara për punë me FNV, si p.sh. pajisje ndihmëse për komunikim, mjete për zhvillimin motorik dhe material didaktik të përshtatur.

Është gjithashtu e nevojshme të fuqizohet ekipi vlerësues pedagogjik për FNV në nivel të komunës, në mënyrë që për secilin fëmijë të jepet një vlerësim i drejtë dhe të vendoset në mjedisin që është në interesin e tij më të mirë. Ky ekip duhet të përbëhet nga specialistë të fushave të ndryshme, përfshirë psikologë, logopedë , nëpunës nga Qendra për Punë Sociale dhe ekspertë të edukimit special, për të ofruar një vlerësim gjithëpërfshirës dhe multidisiplinar.

Komuna e Obiliqit ka tanimë 7 asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta dhe shtimi i numrit të tyre duhet të vazhdojë deri në plotësimin e standardeve minimale të përcaktuara për këtë kategori të punonjësve. Përveç shtimit të numrit, është thelbësore që asistentët të jenë të trajnuar mirë dhe të pajisur me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të mbështetur efektivisht fëmijët me nevoja të veçanta.

Ndër të tjera, është e rëndësishme të sigurohen trajnime të vazhdueshme për asistentët dhe mësimdhënësit, duke përfshirë edhe trajnimet për teknikat më të reja dhe praktikat më të mira në edukimin special. Gjithashtu, duhet të organizohen programe mbështetëse për prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta, për t'i ndihmuar ata të kuptojnë dhe të mbështesin zhvillimin e fëmijëve të tyre në mënyrë më efektive.

### 1.4. Rishikimi i profileve dhe i kuotave për regjistrim në AAP

Në dy shkollat e mesme të larta të Komunës së Obiliqit, 55% e nxënësve vijojnë mësimet në arsimin profesional, ndërsa 45% ndjekin gjimnazet. Një numër i konsiderueshëm i nxënësve nga Komuna e Obiliqit vazhdojnë shkollimin e mesëm në Prishtinë, sidomos në drejtimet, të cilat nuk ofrohen në dy shkollat e mesme të larta të Obiliqit. Kjo situatë krijon një sfidë për balancimin e kuotave dhe profileve

të ofruara brenda komunës, duke marrë parasysh nevojat dhe interesat e nxënësve, si dhe kërkesat e tregut të punës.

Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) duhet t'i rishikojë rregullisht profilet dhe kuotat për regjistrim në arsimin profesional, duke u përshtatur me mundësitë dhe kërkesat e tregut të punës. Ky rishikim duhet të bazohet në analiza të detajuara të trendeve të punësimit dhe nevojave të sektorëve ekonomikë në komunë dhe më gjerë. Përveç kësaj, duhet të merren parasysh mundësitë për realizimin e praktikës profesionale në kompanitë lokale, duke siguruar që nxënësit të kenë përvojë praktike relevante gjatë arsimimit të tyre.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është bashkëpunimi i ngushtë me bizneset lokale për të krijuar partneritete ,që mund të ndihmojnë në përcaktimin e profileve më të kërkuara dhe në ofrimin e vendeve të praktikës për nxënësit. Kjo do të mundësojë një lidhje më të mirë midis arsimit dhe tregut të punës, duke rritur mundësitë e punësimit për të diplomuarit.

Për drejtimet që nuk ekzistojnë në Komunën e Obiliqit dhe që janë të kërkuara nga nxënësit, do të vazhdojë mbështetja në formë të mbulimit të shpenzimeve të udhëtimit për ata që vazhdojnë shkollimin në Prishtinë. Kjo mbështetje është jetike për të siguruar që të gjithë nxënësit të kenë mundësinë të ndjekin drejtimin e dëshiruar dhe të marrin një arsimim cilësor, pavarësisht nga vendndodhja e shkollës.

Për të përmirësuar më tej procesin e rishikimit të profileve dhe kuotave, DKA duhet të zhvillojë një mekanizëm të rregullt konsultimi me palët e interesuara, duke përfshirë nxënësit, prindërit, mësimdhënësit, dhe përfaqësuesit e industrisë. Kjo do të sigurojë që vendimet e marra të jenë të informuara dhe të reflektojnë nevojat reale të komunitetit dhe tregut të punës.

### 3.2.2. Mësimdhënia dhe të nxënit

| |
|---|
| **Objektivi Strategjik 2.** Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit në të gjitha shkollat e Komunës së Obiliqit përmes sigurimit të burimeve të nevojshme, ofrimit të mbështetjes për të gjithë nxënësit dhe fuqizimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë. |

Objektivi Strategjik 2 është thelbësor për përmbushjen e misionit të përmirësimit të cilësisë së arsimit parauniversitar në Komunën e Obiliqit. Mësimdhënia dhe të nxënit janë në qendër të çdo sistemi arsimor, dhe përmirësimi i tyre është një hap kritik për të siguruar që nxënësit të marrin një edukim të cilësisë së lartë që i përgatit ata për të ardhmen. Për të arritur këtë objektiv, janë parashikuar disa masa kyçe. Masat përfshijnë sigurimin e mjeteve të konkretizimit për shkolla, fuqizimin e rolit të koordinatorëve të cilësisë, riorganizimin e rrjetit të shkollave dhe paraleleve të ndara, organizimin e mësimit plotësues dhe shtues, si dhe organizimin e punës praktike dhe praktikës profesionale për nxënësit e AAP. Këto masa synojnë të sigurojnë që të gjitha shkollat të kenë burimet e nevojshme, të ofrohet mbështetje për të gjithë nxënësit dhe të forcohen mekanizmat e sigurimit të cilësisë për të arritur një mësimdhënie dhe të nxënit efektiv dhe tërheqës.

**Masat**

**2.1. Sigurimi i mjeteve të konkretizimit për shkolla**

Sigurimi i mjeteve të konkretizimit është thelbësor për të përmirësuar cilësinë e procesit mësimor dhe për të mundësuar një mësimdhënie efektive dhe tërheqëse për nxënësit. Mjetet e konkretizimit përfshijnë pajisje dhe materiale didaktike, që ndihmojnë në shpjegimin e koncepteve dhe teorive të ndryshme, duke e bërë mësimin më të prekshëm dhe të kuptueshëm për nxënësit. Ky aktivitet përfshin disa hapa kryesorë.

Në fillim, kryhet një analizë e detajuar për të identifikuar nevojat specifike të shkollave në nivele të ndryshme të arsimit (parashkollor, fillor, i mesëm i ulët dhe i lartë). Kjo përfshin konsultimin me mësimdhënësit dhe drejtuesit e shkollave për të marrë sugjerime dhe rekomandime mbi mjetet më të nevojshme dhe më të dobishme për mësimdhënie efektive. Në bazë të kësaj analize, zhvillohet një listë e standardizuar e mjeteve të konkretizimit që duhet të jenë të pranishme në çdo shkollë, të ndarë sipas niveleve të arsimit dhe lëndëve mësimore. Kjo përfshin mjete të tilla si tabela të bardha, modele shkencore, laboratorë të lëndëve natyrore, pajisje për edukimin fizik, etj. Mjetet e TIK janë trajtuar në kuadër të objektivit 5.

Pasi të jetë përcaktuar pakoja minimale e mjeteve të konkretizimit, hartohet një plan për blerjen dhe shpërndarjen e tyre në të gjitha shkollat e komunës. Ky plan përfshin identifikimin e burimeve financiare të mundshme, duke përfshirë buxhetin komunal, donacionet dhe fondet e ndryshme. Nevojat e shkollave dhe lëndëve prioritizohen në bazë të urgjencës dhe rëndësisë, dhe vendoset një kalendar për blerjen dhe shpërndarjen e mjeteve.

Shkëmbimi i përvojave është një element i rëndësishëm i këtij aktiviteti. Organizimi i takimeve dhe seminareve të rregullta me mësimdhënësit dhe drejtuesit e shkollave ndihmon në ndarjen e përvojave dhe praktikave më të mira për përdorimin e mjeteve të konkretizimit. Kjo nxit një kulturë të bashkëpunimit dhe të mësimit të vazhdueshëm, duke siguruar që mjetet e blera të përdoren në mënyrë sa më efektive dhe të kenë një ndikim pozitiv në procesin mësimor.

### 2.2. Fuqizimi i rolit të koordinatorëve të cilësisë në shkolla

Për të siguruar një mësimdhënie dhe të nxënë të cilësisë së lartë, është thelbësore të fuqizohet roli i koordinatorëve të cilësisë në shkolla. Ky proces fillon me emërimin e koordinatorëve të cilësisë konform Udhëzimit Administrativ nr. 24/2016. Përzgjedhja duhet të bëhet nga radhët e personelit që kanë aftësi dhe potencial për të qenë efektivë në këtë rol, duke siguruar që personat e emëruar të kenë një kuptim të thellë të proceseve arsimore dhe të jenë të angazhuar në përmirësimin e cilësisë së arsimit.

Pas emërimit, është e nevojshme që koordinatorët e cilësisë të marrin trajnimin e duhur. MASHTI duhet të ofrojë këto trajnime dhe është e rëndësishme që të bëhen kërkesa të vazhdueshme për trajnime të reja dhe të avancuara. Trajnimet duhet të përfshijnë teknika dhe strategji për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë në shkolla, si dhe mënyra për të implementuar standardet dhe politikat e cilësisë.

Edhe pse në nivelin e Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) ekziston një koordinator i cilësisë, është thelbësore që t'i krijohet hapësirë dhe mundësi për të zhvilluar aktivitetet e tij. Kjo përfshin lirimin ngarkesa të tepërta administrative, si dhe sigurimin e burimeve të nevojshme për të kryer detyrat e tij në mënyrë efektive.

Për të siguruar një rrjedhë të vazhdueshme të informacioneve dhe përvojave, duhet të organizohen konsultime të rregullta mes koordinatorëve të cilësisë. Këto takime mund të ndihmojnë në ndarjen e praktikave të mira, zgjidhjen e problemeve të përbashkëta dhe zhvillimin e strategjive të reja për përmirësimin e cilësisë në të gjitha shkollat e komunës. Në këtë mënyrë, koordinatorët e cilësisë do të mund të punojnë së bashku për të ngritur standardet e arsimit dhe për të siguruar që çdo shkollë të ofrojë një mësimdhënie dhe mësim të cilësisë së lartë.

## 2.3. Rishikimi i rrjetit të shkollave dhe paraleleve të ndara me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimit

Për të përmirësuar cilësinë e mësimit në Komunën e Obiliqit, është e nevojshme të rishikohet rrjeti i shkollave dhe paraleleve të ndara. Ky proces fillon me analizën e gjendjes aktuale dhe trendeve demografike, për të identifikuar zonat, ku numri i nxënësve është në rënie dhe ku riorganizimi është më i domosdoshëm. Analiza duhet të marrë parasysh faktorin e distancës, infrastrukturën ekzistuese dhe tendencat e ardhshme të popullsisë.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është sigurimi i angazhimit për mësimdhënësit që mbeten tepricë pas riorganizimit. Këta mësimdhënës mund të sistemohen për të mbuluar nevojat në shkolla të tjera ose për të ndihmuar në zbatimin e programeve shtesë mësimore. Kjo siguron që stafi arsimor të mos humbasë vendet e punës dhe të mbetet një resurs i vlefshëm për komunitetin.

Konsultimet me komunitetin janë thelbësore për të siguruar që riorganizimi të pranohet dhe të kuptohet nga të gjithë të interesuarit. Këto konsultime duhet të përfshijnë prindërit, mësimdhënësit dhe anëtarët e komunitetit, duke ofruar një platformë për të diskutuar përfitimet dhe sfidat e mundshme të ndryshimeve të propozuara.

Sigurimi i transportit për nxënësit është një masë kritike për të siguruar që askush të mos mbetet jashtë sistemit arsimor për shkak të largësisë. Ky transport duhet të jetë i rregullt, i sigurt dhe i besueshëm, duke mundësuar nxënësve të mbërrijnë në shkollë pa probleme.

## 2.4. Organizimi i mësimit plotësues dhe shtues

Një nga mënyrat për të përmirësuar rezultatet arsimore është organizimi i mësimit plotësues për nxënësit që ngecin në mësime dhe mësimit shtues për nxënësit me prirje të veçanta. Organizimi i formave të tilla të mësimit paraqet sfidë, pasi mësimdhënësit kanë ngarkesat mësimore me mësimin e rregullt dhe mundësitë e tyre për të bërë punë shtesë janë të kufizuara. Për të sforcuar aktivitetet e kësaj natyre mund të shfrytëzohen mësimdhënësit, të cilët mbeten tepricë, qoftë ;për shkak të zvogëlimit të normave mësimore, ose për shkak të riorganizimit eventual të rrjetit shkollor.

Bashkëpunimi me organizatat që mbështesin talentet është gjithashtu i rëndësishëm. Këto organizata mund të ofrojnë burime dhe ekspertizë shtesë për të ndihmuar nxënësit që kanë prirje të veçanta, duke i përgatitur ata për gara dhe konkurse akademike. Ky bashkëpunim mund të ndihmojë në zhvillimin e potencialit të plotë të nxënësve.

Përgatitja e nxënësve për testin e arritshmërisë dhe testin e maturës është një tjetër aspekt kyç. Këto teste janë të rëndësishme për të matur nivelin e njohurive të nxënësve dhe për të siguruar që ata janë të përgatitur për hapat e ardhshëm në arsimin e tyre. Shkollat duhet të organizojnë seanca përgatitore dhe të ofrojnë udhëzime specifike për këto teste.

Stimulimi i nxënësve për arritje të rezultateve është po ashtu thelbësor. Kjo mund të përfshijë shpërblime për nxënësit që shënojnë rezultate në gara, duke krijuar një mjedisi që inkurajon përpjekjet dhe suksesin akademik. Shpërblime mund të jenë në formë të certifikatave, dhuratave, mjeteve monetare apo njohjes publike të arritjeve të tyre.

## 2.5. Organizimi i punës praktike dhe praktikës profesionale për nxënësit e AAP

SHMLP "Ismail Dumoshi", tanimë e pajisur me kabinete të avancuara dhe punëtori moderne, ofron një mjedis solid për zhvillimin e aftësive praktike të nxënësve. Për të maksimizuar përfitimet nga këto burime, është e domosdoshme të sigurohen disa elemente kyçe në procesin e organizimit të punës praktike dhe praktikës profesionale.

Sigurimi i materialit shpenzues është një hap i parë dhe i domosdoshëm. Materialet e nevojshme për aktivitetet praktike duhet të jenë gjithmonë në dispozicion për nxënësit, duke përfshirë mjete, pajisje dhe materiale konsumuese që ndihmojnë në realizimin e detyrave praktike. Disponueshmëria e këtyre materialeve siguron që çdo nxënës të ketë mundësinë të zhvillojë aftësitë e tij në mënyrë efektive dhe pa ndërprerje.

Punësimi i instruktorëve të kualifikuar është një aspekt tjetër thelbësor. Instruktorët duhet të kenë përvojë të gjerë në fushat përkatëse dhe të jenë të aftë për të udhëhequr dhe mbështetur nxënësit gjatë aktiviteteve praktike. Përveç kësaj, është e rëndësishme që instruktorët të përditësojnë vazhdimisht njohuritë e tyre përmes trajnimeve dhe zhvillimit profesional, duke siguruar kështu që ata të jenë gjithmonë të përgatitur për të ofruar mësim cilësor dhe të azhurnuar.

Kryerja e praktikës profesionale në kompani lokale është një komponent thelbësor i arsimit dhe aftësimit profesional. Nxënësit duhet të kenë mundësinë të zbatojnë njohuritë e tyre teorike në mjedise reale pune, duke fituar përvojë të vlefshme dhe duke zhvilluar aftësi praktike që janë të kërkuara në tregun e punës. SHMLP "Ismail Dumoshi" duhet të vazhdojë të forcojë bashkëpunimin me bizneset lokale për të siguruar që nxënësit të kenë qasje në praktika profesionale cilësore. Kjo përvojë ,jo vetëm që i ndihmon nxënësit të lidhen më mirë me fushën e tyre të studimit, por gjithashtu rrit mundësitë e tyre për punësim të suksesshëm pas përfundimit të arsimit të tyre.

**2.6. Stimulime për mësimdhënësit, nxënësit e dalluar dhe studentët**

Komuna e Obiliqit do të vazhdojë praktikën e ndarjes së shpërblimeve vjetore për mësimdhënësit e dalluar në të gjitha nivelet e arsimit. Po ashtu, do të vazhdojë praktika e ndarjes së bursave për nxënësit e shkëlqyeshëm të shkollave të mesme të larta. Dhënia e bursave për nxënësit e shkollave të mesme të larta profesionale do të bëhet nga klasa e dhjetë, ndërsa për nxënësit e gjimnazit nga klasa e 11-të. Përveç kësaj, e me qëllim të sigurimit të kuadrit me arsimim të lartë, Komuna do të ndajë bursa edhe për studentë të nivelit baçelor, master dhe të doktoratës.

## 3.2.3. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve

| |
|---|
| **Objektivi Strategjik 3.** Rritja e kapaciteteve profesionale të mësimdhënësve në Komunën e Obiliqit për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënit |

Rritja e kapaciteteve profesionale të mësimdhënësve është një komponent kyç për përmirësimin e cilësisë së arsimit në Komunën e Obiliqit. Investimi në zhvillimin profesional të mësimdhënësve siguron që ata të jenë të përgatitur për të përmbushur sfidat e reja arsimore dhe të përdorin metodat më të mira mësimore për të nxitur suksesin e nxënësve.

**Masat**

**3.1. Analiza e nevojave për trajnime**

Për të siguruar një vlerësim të saktë dhe të plotë të nevojave për zhvillim profesional të mësimdhënësve, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) do të ftojë për bashkëpunim një organizatë të specializuar në këtë fushë. Kjo organizatë mund të jetë një nga ofruesit e programeve të trajnimit ose Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK), një institucion i MASHTI-së i destinuar për hulumtime në arsim.

DKA do të themelojë një grup pune të përbërë nga zyrtarë të DKA dhe ekspertë lokalë për të mbështetur procesin e analizës së nevojave për zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Ky grup do të luajë një rol kyç në hartimin e metodologjisë për analizën e nevojave për trajnime, duke u bazuar në konsultime të gjera me shkollat dhe mësimdhënësit individualë. Metodologjia do të përfshijë teknika të ndryshme të mbledhjes së të dhënave, si pyetësorë, intervista dhe grupe fokusi, për të siguruar një kuptim të plotë të nevojave të mësimdhënësve.

Analiza e nevojave do të përfshijë identifikimin e nevojave specifike të trajnimit për çdo mësimdhënës dhe shkollë, duke marrë parasysh veçoritë e çdo institucioni arsimor dhe sfidat specifike që ata përballen. Rezultatet e kësaj analize do të përpunohen dhe sintetizohen në nivel komunal për të hartuar plane zhvillimore të personalizuara dhe për të ndarë buxhetin e nevojshëm për këtë qëllim.

Këto analiza do të kryhen të paktën një herë në tre vjet, duke mundësuar një përditësim të vazhdueshëm të nevojave dhe planeve për zhvillim profesional. Ky proces periodik do të sigurojë që DKA të jetë në gjendje të përshtatet me ndryshimet në mjedisin arsimor dhe të adresojë në mënyrë efektive sfidat dhe nevojat e reja që mund të shfaqen.

### 3.2. Ofrimi i mundësive për trajnimin e personelit mësimor

Në përputhje me Ligjin për Arsimin në Komuna të Republikës së Kosovës, DKA-Obiliq do të ndërtojë kapacitete për menaxhimin e procesit të zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Fillimisht, kjo do të arrihet përmes emërimit të një zyrtari përgjegjës për zhvillimin profesional në nivelin e DKA, i cili do të jetë përgjegjës për hartimin e planeve vjetore për zhvillimin profesional, bazuar në analizën e nevojave. Trajnimet do të organizohen në nivel komunal dhe shkollor, dhe përzgjedhja e pjesëmarrësve do të bëhet në përputhje me nevojat e identifikuara. Do të inkurajohen veçanërisht trajnimet me bazë në shkollë dhe ato, që zhvillohen në kuadër të aktiveve komunale (masa 3.3). Për më tepër, DKA do të bashkëpunojë me institucione qendrore, organizata joqeveritare dhe donatorë për të siguruar burimet e nevojshme për trajnime cilësore dhe të përshtatshme.

### 3.3. Organizimi i rrjeteve të mësimdhënësve sipas fushave kurrikulare

Përveç fuqizimit të aktiveve profesionale në shkolla (masa 4.1), do të ndërtohen aktive në nivel të komunës sipas fushave kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Matematika, Shkencat natyrore, Shoqëria dhe mjedisi, Edukata fizike, sportet dhe shëndeti dhe Jeta dhe puna. Ky lloj organizimi do të mundësojë shkëmbimin e vazhdueshëm të përvojave ndërmjet mësimdhënësve lëndorë. Në disa fusha, mësimdhënësit mund të organizohen edhe sipas niveleve. Për mësuesit klasorë do të organizohet një strukturë e veçantë. Këto rrjete do të nxisin bashkëpunimin dhe ndarjen e praktikave më të mira, duke ndihmuar mësimdhënësit të zhvillojnë dhe përmirësojnë vazhdimisht metodologjitë e tyre mësimore.

### 3.2.4. Udhëheqja dhe menaxhimi

**Objektivi Strategjik 4.** Ngritje e efikasitetit dhe efektivitetit në menaxhim nëpërmjet forcimit të transparencës, llogaridhënies dhe bashkëpunimit

Udhëheqja dhe menaxhimi janë thelbësore për arritjen e një arsimi cilësor dhe për të përmbushur misionin e për përmirësimin e cilësisë së arsimit parauniversitar. Udhëheqja efektive ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në motivimin e mësimdhënësve, përmirësimin e mjedisit mësimor, dhe në përfshirjen e të gjithë nxënësve në procesin arsimor. Menaxhimi i mirë garanton që resurset të shfrytëzohen në mënyrën më efikase dhe që të gjitha proceset arsimore të zhvillohen në një mjedis transparent dhe llogaridhënës.

Në kuadër të Objektivit Strategjik 4, masat specifike përfshijnë fuqizimin e strukturave udhëheqëse në shkolla për të garantuar që ato të funksionojnë si duhet dhe të përballen me sfidat e arsimit modern. Kjo përfshin përmirësimin e këshillave drejtues, të cilët luajnë një rol kyç në vendimmarrjen strategjike dhe në zbatimin e politikave arsimore. Një tjetër fokus është ofrimi i mundësive të zhvillimit profesional për personelin menaxhues dhe mësimor që synojnë poste menaxheriale. Për të stimuluar performancën e lartë, DKA propozon gjithashtu një program incentivash për drejtorët e shkollave, duke përfshirë njohjen e drejtorëve të dalluar me titullin "Drejtori i Vitit" bazuar në kriteret e përcaktuara të performancës dhe kontributit ndaj përmirësimit të shkollës që ata menaxhojnë. Së fundi, ndërtimi i një strukture efektive për menaxhimin e arsimit në DKA është esencial për të mbështetur këto nisma. Kjo do të përfshijë rishikimin e funksioneve dhe përgjegjësive, për të siguruar që të gjithë zyrtarët e DKA janë të pajisur dhe të motivuar për të menaxhuar sfidat e arsimit në mënyrë efikase dhe efektive.

**Masat**

**4.1. Fuqizimi i këshillave drejtues dhe organeve të tjera të shkollës**

Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) e Obiliqit ka për qëllim të sigurojë që këshillat drejtues të shkollave të jenë plotësisht funksionalë në të gjitha shkollat e komunës, duke u përpjekur të shmangë përdorimin e normës ligjore që lejon që, në rastet e këshillave drejtues jofunksionalë, drejtori i shkollës të marrë rolin e tyre. Kjo normë duhet të zbatohet vetëm në rrethana të veçanta, kur nuk ekzistojnë kushte për funksionimin normal të këshillave drejtues.

Në situata ku anëtarët e këshillave drejtues mungojnë ose janë të paaftë për të kryer detyrat e tyre, DKA do të ndërhyjë duke emëruar përfaqësues të komunës në këto këshilla për të siguruar që ato të funksionojnë siç duhet. Anëtarët e emëruar do të marrin pjesë aktive në vendimmarrjen dhe zhvillimin strategjik të shkollave të tyre. Për më tepër, DKA do të organizojë trajnime për anëtarët e këshillave drejtues, të mbështetura nga MASHT-i dhe donatorët, për të rritur kapacitetet e tyre në menaxhimin e çështjeve shkollore dhe zbatimin e politikave arsimore.

Për të siguruar transparencën dhe llogaridhënien e veprimtarive të këshillave drejtues, DKA do të kërkojë raporte të rregullta mbi mbajtjen e mbledhjeve dhe, sipas rastit, kopje të procesverbaleve të mbledhjeve të tyre. Kjo do të ndihmojë në monitorimin e veprimtarive të këshillave dhe në identifikimin e çështjeve që mund të kërkojnë ndërhyrje ose mbështetje shtesë.

Përveç këshillave drejtues, DKA do të nxisë funksionalitetin e këshillave të prindërve dhe organeve të tjera vitale shkollore siç janë aktivet profesionale. Këto aktive janë platforma ,ku mësimdhënësit mund

të bashkëpunojnë, të konsultohen rreth planifikimit të punës dhe të ndërveprojnë për zhvillimin profesional përmes mësimit bashkërisht (peer learning). Ato gjithashtu ofrojnë mbështetje të ndërsjellë dhe mundësi për monitorim të brendshëm përmes shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira.

Përfundimisht, fuqizimi i këtyre strukturave është thelbësor për të rritur cilësinë e arsimit dhe për të promovuar një kulturë të bashkëpunimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm në shkollat e Komunës së Obiliqit.

### 4.2. Ofrimi i mundësve për zhvillimin profesional të personelit menaxhues dhe personelit mësimor që synojnë poste menaxheriale

Në Komunën e Obiliqit, të gjithë drejtorët dhe zëvendësdrejtorët e shkollave kanë përfunduar me sukses trajnimet e detyrueshme për udhëheqje shkollore. Këto trajnime janë një bazë e fortë, por për të qëndruar në hap me ndryshimet e vazhdueshme në fushën e arsimit dhe për të përballuar sfidat që sjellin inovacionet dhe ndryshimet shoqërore, kërkohet një përgatitje më të thellë dhe të specializuar.

Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) e Obiliqit është e përkushtuar të sigurojë qasje në trajnime të avancuara dhe të specializuara për këta menaxherë shkollorë. Këto trajnime do të jenë të organizuara jo vetëm nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHTI), por edhe nga ofertues të tjerë të programeve të trajnimit që janë të njohur për ekspertizën e tyre në fushën e udhëheqjes dhe menaxhimit arsimor. Trajnimet do të fokusohen në aspekte të ndryshme të udhëheqjes, si menaxhimi i ndryshimeve, komunikimi efektiv, zgjidhja e konflikteve, dhe inovacionet në edukim.

Në raste të veçanta, në varësi të nevojave të identifikuara dhe kërkesave të personelit menaxhues, DKA mund të financojë pjesëmarrjen në këto trajnime. Kjo do të ndihmojë në mbështetjen e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, duke i përgatitur ata më mirë për të përballuar sfidat e ardhshme dhe për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e tyre në menaxhimin e shkollave.

Përveç përkushtimit ndaj personelit menaxhues aktual, DKA po ashtu inkurajon mësimdhënësit që kanë ambicie për të ndjekur karrierë në udhëheqjen arsimore, të marrin pjesë në trajnime për udhëheqje. Kjo përfshin nxitjen e mësimdhënësve për të ndjekur kurse dhe seminare që trajtojnë tema relevante për udhëheqjen, siç janë strategjitë menaxheriale, planifikimi strategjik dhe marrëdhëniet ndërinstitucionale. Kjo do t'i ndihmojë ata të krijojnë një rrugë të qartë drejt roleve udhëheqëse në të ardhmen dhe do të kontribuojë në zhvillimin e një brezi të ri të liderëve arsimorë që mund të sjellin ndryshime pozitive në sistemin arsimor të komunës.

### 4.3. Stimulime për performancën e drejtorëve të shkollave

Drejtori i shkollës luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe mirëfunksionimin e institucionit arsimor që udhëheq. Përgjegjësitë e tij kritike përfshijnë, jo vetëm menaxhimin e përditshëm, por edhe sigurimin e një mjedisi të përshtatshëm për mësimdhënie dhe të nxënë. Megjithatë, pavarësisht vlerësimit vjetor të performancës së drejtorëve, sistemi aktual nuk ofron incentiva të qarta për njohjen e performancës së lartë, një boshllëk që mund të ndikojë në motivimin e drejtorëve për përmirësim të vazhdueshëm.

Në përgjigje të kësaj nevoje, Komuna e Obiliqit do të implementojë një program stimulimi që synon të njohë dhe të shpërblejë drejtorët që tregojnë performancë të shkëlqyer. Kjo iniciativë do të përfshijë shpalljen e një çmimi vjetor "Drejtori i Vitit". Ky çmim do të jepet bazuar në një sërë kriteresh të parapërcaktuara, të cilat do të përfshijnë ,jo vetëm vlerësimin e performancës individuale sipas

standardeve të përcaktuara nga DKA, por edhe përparimin dhe ndikimin që institucioni që drejtojnë ka bërë gjatë vitit. Kriteret do të përfshijnë inovacionet në metodat e mësimdhënies, përmirësimin e rezultateve të nxënësve, dhe angazhimin e komunitetit.

Përveç çmimit "Drejtori i Vitit", do të ketë gjithashtu mirënjohje dhe forma të tjera të njohjes për drejtorët që arritën suksese të jashtëzakonshme ose kanë bërë përmirësime të rëndësishme në aspekte specifike të menaxhimit shkollor. Këto mund të përfshijnë avancimin e procesit mësimor, bashkëpunime të suksesshme me organizata joqeveritare ose ndërmarrje private, dhe implementimin e projekteve të inovacionit që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e kushteve mësimore dhe arsimore në shkollë.

Nëpërmjet këtyre stimulimeve, Komuna e Obiliqit synon të krijojë një mjedis, ku përpjekja dhe inovacioni në fushën e arsimit, jo vetëm njihen, por edhe shpërblehen. Kjo strategji pritet të nxisë drejtorët e shkollave të angazhohen më aktivisht në përmirësimin e performancës së tyre dhe të institucioneve që ata drejtojnë, duke kontribuuar në një sistem arsimor më dinamik dhe efektiv në Komunën e Obiliqit.

### 4.4. Ndërtimi i strukturës për menaxhim efektiv të arsimit në DKA

Procesi i decentralizimit, i cili po zhvillohet gjatë dy dekadave të fundit, ka kërkuar një rishikim të thellë dhe të vazhdueshëm të strukturave menaxhuese në Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA). Ky rishikim është i domosdoshëm për të përshtatur funksionet dhe përgjegjësitë me kompetencat që janë transferuar nga niveli qendror në atë lokal. Një ristrukturim i tillë synon të përmirësojë efikasitetin dhe reagimin ndaj nevojave të ndryshme të shkollave në komunë.

Rishikimi funksional i strukturës menaxhuese në DKA mund të zhvillohet si një pjesë e një procesi më të gjerë që përfshin të gjitha drejtoritë dhe zyrat e administratës komunale, ose si një iniciativë e veçantë që synon përmirësimin e menaxhimit të arsimit. Pavarësisht nga qasja, ky proces do të përqendrohet në identifikimin dhe emërimin e personave me përgjegjësi të qarta për çështje të caktuara që ndikojnë në funksionimin e shkollave. Në këtë kontekst, është esenciale të kuptohet se shtimi i pozicioneve të reja të punës nuk është domosdoshmërisht i nevojshëm për çdo aspekt të menaxhimit shkollor. Më tepër, qëllimi është të rishikohet dhe të racionalizohet shpërndarja e detyrave për të përmirësuar efikasitetin. Kjo mund të përfshijë ristrukturimin e roleve aktuale për të shtuar fokusin në përgjegjësitë kryesore dhe për të nxitur një menaxhim më të mirë të resurseve.

Procesi i rishikimit do të kërkojë gjithashtu një vlerësim të rregullt të performancës dhe një sistem të fortë të llogaridhënies, për të siguruar që të gjithë përgjegjësit të funksioneve të caktuara të jenë në gjendje të përmbushin objektivat e tyre. Përgjatë kësaj ristrukturimi, DKA do të mbështetet në trajnime dhe zhvillim profesional të vazhdueshëm për të siguruar që stafi menaxhues të jetë i pajisur me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të përballuar sfidat e menaxhimit të arsimit në një mjedis të decentralizuar.

### 4.5. Nxitja e bashkëpunimit në mes të shkollave, komunitetit, OJQ-ve dhe bizneseve lokale

Në një botë që ndryshon me shpejtësi, bashkëpunimi i fortë në mes të shkollave, komunitetit, organizatave joqeveritare dhe bizneseve lokale bëhet thelbësor për të siguruar që arsimi të mbetet relevant dhe t'i përgjigjet nevojave të tregut të punës dhe zhvillimeve shoqërore. Kjo kërkesë ka shtyrë Drejtorinë Komunale të Arsimit në Obiliq të vendosë në strategjinë e saj nxitjen dhe zhvillimin e bashkëpunimeve strategjike që synojnë të fuqizojnë dhe të zgjerojnë burimet dhe mundësitë për

nxënësit dhe mësimdhënësit. Kjo mund të përfshijë projekte edukative që lidhen me mjedisin, ndërmarrësinë, teknologjinë dhe aftësitë sociale, të cilat janë jetike për përgatitjen e nxënësve për sfidat e ardhshme.

Për më tepër, DKA do të inkurajojë dhe mbështesë organizimin e aktiviteteve dhe ngjarjeve të përbashkëta, siç janë panairet e karrierës, seminaret e ndërmarrësisë dhe workshopet e teknologjisë, ku bizneset dhe OJQ-të mund të marrin pjesë aktivisht dhe të kontribuojnë me ekspertizën dhe resurset e tyre. Këto ngjarje jo vetëm që nxisin mësimin praktik dhe të orientuar nga realitetet e tregut, por gjithashtu forcojnë lidhjet në mes të shkollës dhe komunitetit më të gjerë.

Së fundmi, DKA do të ndërmarrë hapa për të nxitur dhe mbështetur krijimin e partneriteteve afatgjata mes shkollave dhe bizneseve lokale, të cilat mund të përfshijnë sponsorizime për aktivitete dhe projekte specifike, si dhe mundësi për praktikë profesionale për nxënësit. Këto partneritete do të lejojnë që nxënësit të marrin përvojë praktike që është e lidhur drejtpërdrejt me kërkesat dhe mundësitë e tregut lokal të punës.

### 3.2.5. Mjedisi dhe kultura institucionale

**Objektivi Strategjik 5.** Sigurimi i mjediseve shkollore të përshtatshme, të sigurta dhe të pajisura me teknologji sipas normave dhe standardeve që mundësojnë mësim cilësor

Një infrastrukturë e përshtatshme dhe e pajisur mirë është thelbësore për cilësinë e arsimit, duke u mundësuar nxënësve qasje në një mjedis mësimor stimulues dhe mbështetës. Ky objektiv është në linjë me misionin e PZHKA për të ofruar një arsim cilësor për të gjithë, duke krijuar kushte të barabarta për të mësuar dhe zhvilluar aftësitë individuale të çdo nxënësi. Masat e Objektivit Strategjik 5 përfshijnë përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe sigurimin e mjediseve të sigurta dhe të pajisura me teknologji; furnizimin e bibliotekave me libra dhe sisteme të katalogimit elektronik; identifikimin, parandalimin dhe menaxhimin e dhunës dhe bullizmit nëpër shkolla; mirëmbajtjen e rregullt të hapësirave arsimore dhe stimulimin e pastërtisë; sigurimin e qasjes në internet dhe ndërtimin e rrjeteve lokale në të gjitha shkollat; si dhe pajisjen e shkollave me teknologji të avancuar dhe krijimin e klubeve të nxënësve për mirëmbajtjen e pajisjeve digjitale.

**Masat**

**5.1. Evidentimi i nevojave për përmirësime në infrastrukturë dhe planifikimi i investimeve**

Në vazhdim të përmirësimit të infrastrukturës arsimore, Komuna e Obiliqit ka identifikuar dhe planifikuar ndërtimin e një objekti të ri shkollor në oborrin e SHFMU "Dr.Ibrahim Rugova" në Obiliq. Ky hap synon të ofrojë hapësira mësimore më të mëdha dhe më të përshtatshme për nxënësit dhe të eliminojë nevojën e punës në dy ndërrime. Gjithashtu, është parashikuar ndërtimi i një shkolle të re në fshatin Babimoc, e cila do të shërbejë për të dy komunitetet, shqiptare dhe serbe, për të nxitur bashkëjetesën dhe të mësuarit ndërkulturor. Përkrah këtyre projekteve kapitale, Komuna planifikon gjithashtu investime në blerjen e inventarit të ri shkollor dhe kryerjen e riparimeve të domosdoshme për të përmirësuar kushtet aktuale të infrastrukturës shkollore. Këto veprime do të monitorohen dhe rregullohen nëpërmjet cikleve të rregullta të planifikimit, me synimin për të adresuar nevojat specifike të çdo institucioni arsimor në komunë.

### 5.2. Furnizimi i bibliotekave shkollore me libra

Për të pasuruar koleksionet e bibliotekave shkollore dhe për të nxitur kulturën e leximit, DKA e Obiliqit do të iniciojë një plan të detajuar për furnizimin e bibliotekave me libra të rinj dhe të larmishëm. Kjo përfshin sistemin e katalogimit elektronik për të menaxhuar me efikasitet inventarin dhe për të siguruar që të gjithë nxënësit dhe mësimdhënësit të kenë qasje në resurset e nevojshme. Shtimi i librit të ri do të mbështetet gjithashtu nga fushata "dhuro libra", ku ish-nxënësit dhe anëtarët e komunitetit inkurajohen të kontribuojnë me tituj në bibliotekat e tyre lokale shkollore.

### 5.3. Identifikimi, parandalimi dhe raportimi i dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit

DKA e Obiliqit zbaton një politikë të tolerancës zero ndaj dhunës, bullizmit dhe çdo forme të ekstremizmit në shkollat e saj. Kjo është në përputhje me protokollin kombëtar për parandalimin e dhunës, i cili synon të sigurojë një mjedis të sigurt dhe mbështetës për të gjithë nxënësit. Për të arritur këtë, DKA do të organizojë dhe trajnojë ekipe të dedikuara në çdo shkollë për të menaxhuar dhe raportuar rastet e dhunës. Këto ekipe do të përdorin metodat e ndërmjetësimit për të zgjidhur konfliktet në mënyrë paqësore dhe do të zhvillojnë aktivitete vetëdijesuese për të promovuar kulturën e respektit dhe mirëkuptimit ndërmjet nxënësve.

### 5.4. Mirëmbajtja e vazhdueshme e hapësirave arsimore

Mirëmbajtja e vazhdueshme dhe efektive e hapësirave shkollore është thelbësore për të siguruar një mjedis të pastër dhe të sigurt për nxënësit. DKA do të sigurojë mjete dhe materiale higjienike në çdo institucion arsimor dhe do të mbikëqyrë rregullisht standardet e pastërtisë. Një program stimulues, si "Klasa më e pastër" dhe "Shkolla më e pastër", do të nxisë nxënësit dhe mësimdhënësit të angazhohen në mbajtjen e shkollës së tyre në gjendje të mirë, duke krijuar një ndjenjë të përgjegjësisë dhe krenarisë ndaj ambientit të tyre mësimor.

### 5.5. Sigurimi i qasjes në internet dhe ndërtimi i rrjeteve lokale në të gjitha shkollat

Me synimin për të përmirësuar qasjen në burime digjitale dhe për të mbështetur përdorimin efektiv të teknologjisë në mësimdhënie, DKA e Obiliqit ka ndërmarrë hapa për të siguruar qasje në internet broadband dhe për të ndërtuar rrjete lokale (LAN) në çdo shkollë. Kjo përpjekje përfshin instalimin e infrastrukturës së nevojshme të rrjetit për të mundësuar qasje të gjithanshme në internet në klasa, biblioteka, laboratorë dhe zyra, duke u përgjigjur direkt nevojave të një mjedisi arsimor modern dhe të lidhur. Për këtë qëllim, DKA i është drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, e cila ka një projekt për lidhjen e shkollave me internet, prej të cilit tanimë kanë përfituar 5 shkolla të Komunës së Obiliqit

### 5.6. Sigurimi i pajisjeve digjitale për shkollat

Në përputhje me angazhimin për një mësimdhënie inovative dhe interaktive, do të bëhet furnizimi i të gjitha klasave me pajisje digjitale të avancuara, duke përfshirë projektorë, TV smart dhe tabela të mençura. Këto mjete do të ndihmojnë në konkretizimin e procesit mësimor dhe do të lejojnë përdorimin më të gjerë të burimeve digjitale. Së bashku me këto, do të sigurohen kompjuter për përdorim nga mësimdhënësit dhe nxënësit, duke garantuar që teknologjia të integrohet në mënyrë efektive në procesin mësimor. Përveç kompjuterave në klasa, do të synohet që secila shkollë të ketë të paktën një kabinet prej 15-20 kompjuterash për t'u realizuar orët e TIK-ut.

### 5.7. Krijimi i klubeve të nxënësve për mirëmbajtje bazike të pajisjeve digjitale nëpër shkolla

Për të adresuar sfidat e mirëmbajtjes së teknologjisë informative në shkolla, DKA e Obiliqit do të nxisë krijimin e klubeve të nxënësve që do të fokusohen në mirëmbajtjen bazike të pajisjeve të TIK-ut. Këto klube do të funksionojnë nën udhëheqjen e mësimdhënësve të specializuar në TIK dhe do të ofrojnë trajnime për nxënës, duke i përgatitur ata për të kryer detyra themelore të mirëmbajtjes dhe për të ndihmuar në zgjidhjen e çështjeve të vogla teknike që mund të ndodhin përditë. Kjo iniciativë synon të rrisë vetëdijen dhe aftësitë teknologjike të nxënësve, duke i bërë ata pjesëmarrës aktivë në mbajtjen dhe përdorimin e teknologjisë në shkollën e tyre.

# 4. Plani i veprimit dhe buxheti

Plani i veprimit dhe buxheti janë hartuar për gjithë periudhën e zbatimit të Planit Zhvillimor të Arsimit, duke filluar nga viti 2025, përfundimisht me vitin 2029. Si plani i veprimit, ashtu edhe buxheti janë të karakterit orientues dhe duhet të rishikohen para fillimit të çdo viti fiskal. Po ashtu, para fillimit të çdo viti fiskal duhet të përpilohet një plan i detajuar i aktiviteteve për atë vit.

Tabela 7 jep një pasqyrë të buxhetit të nevojshëm për realizimin e Planit Zhvillimor të Komunës sipas pesë objektivave të tij. Në tabelë janë përfshirë vetëm shpenzimet që planifikohet të mbulohen nga buxheti i komunës

**Tabela 7.** Përmbledhja e buxhetit të Planit Zhvillimor të Arsimit

| Objektivi strategjik | | Viti | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Gjithsej |
| 1 | Përmirësimi i përfshirjes në edukim dhe arsim për të gjitha grupet shoqërore | 58,500 | 73,000 | 108,000 | 130,000 | 110,000 | 479,500 |
| 2 | Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit në të gjitha shkollat e Komunës së Obiliqit përmes sigurimit të burimeve të nevojshme, ofrimit të mbështetjes për të gjithë nxënësit dhe fuqizimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë | 353,390 | 377,890 | 378,390 | 378,890 | 378,890 | 1,867,450 |
| 3 | Rritja e kapaciteteve profesionale të mësimdhënësve në Komunën e Obiliqit për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënit | 18,000 | 17,500 | 17,500 | 18,000 | 17,500 | 88,500 |
| 4 | Ngritje e efikasitetit dhe efektivitetit në menaxhim nëpërmjet forcimit të transparencës, llogaridhënies dhe bashkëpunimit | 2,500 | 2,500 | 2,500 | 2,500 | 2,500 | 12,500 |
| 5 | Sigurimi i mjediseve shkollore të përshtatshme, të sigurta dhe të pajisura me teknologji sipas normave dhe standardeve që mundësojnë mësim cilësor | 159,000 | 856,000 | 895,000 | 134,000 | 134,000 | 2,178,000 |
| | | **591,390** | **1,326,890** | **1,401,390** | **663,390** | **642,890** | **4,625,950** |

Nga tabela vërehet se rreth 47% e shpenzimeve të planifikuara ndërlidhen me objektivin strategjik 5 dhe kanë të bëjnë me përmirësim të infrastrukturës shkollore dhe digjitalizim. Investimet e kësaj natyre do të jenë të përqendruara në vitet 2026 dhe 2027, prandaj buxheti për këto vite është dukshëm më i madh se buxheti për vitet tjera. Ndërkaq, rreth 40.4% e buxhetit të planifikuar (1,867,450 EUR) i dedikohet objektivit 2, ku 1,626,950 € janë subvencione për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit, bursa dhe shpërblime.

Në vijim është dhënë plani i detajuar i aktiviteteve sipas objektivave dhe masave të planit zhvillimor të arsimit, me buxhetin e zbërthyer sipas viteve për secilën masë veç e veç.

| Objektivi strategjik 1: | Përmirësimi i përfshirjes në edukim dhe arsim për të gjitha grupet shoqërore | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Masa 1.1** | Rritja e përfshirjes në EFH | | | | | | | | |
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 1.1.1 | Lëshimi në përdorim i objekteve për EFH në Mazgit dhe Milloshevë | 2025 | Ndërtimi i objekteve është në proces | | | | | | |
| 1.1.2 | Organizimi i një fushate sensibilizimi për regjistrimin e fëmijëve në EFH, në veçanti në zonat rurale | 2025-2026 | Bashkëpunimi me MASHTI, IEA dhe organizatat joqeveritare | 1,000 | 500 | 500 | | | 2,000 |
| 1.1.3 | Subvencionimi për regjistrimin e fëmijëve në kopshte private | 2026-2029 | 100 fëmijë x 25 EUR/muaj x 12 muaj = 30,000 EUR/vit | | 10,000 | 30,000 | 30,000 | 30,000 | 100,000 |
| 1.1.4 | Adaptimi i klasave në kuadër të SHF për fëmijët e moshës 4 vjeç | 2027-2028 | 10 klasa x3,000 EUR Nevojitet punësimi i 5 edukatoreve që paguhen nga Granti Specifik i Arsimit | | | 15,000 | 15,000 | | 30,000 |
| 1.1.5 | Adaptimi i klasave në kuadër të SHF për fëmijët e moshës 3 vjeç | 2028-2029 | 10 klasa x3,000 EUR Nevojitet punësimi i 5 edukatoreve që paguhen nga Granti Specifik i Arsimit | | | | 15,000 | 15,000 | 30,000 |
| 1.1.6 | Mbështetja për OJQ që organizojnë forma alternative të EFH | 2028-2029 | 50 fëmijë x 25 eur/muaj x 10 muaj = 12,500 eur/vit | | | | 12,500 | 12,500 | 25,000 |
| | | | Subtotali 1.1 | 1,000 | 10,500 | 45,500 | 72,500 | 57,500 | 187,000 |
| **Masa 1.2** | Përmirësimi i përfshirjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin e arsimit | | | | | | | | |
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 1.2.1 | Aktivitete vetëdijesimi për të siguruar vijimin e rregullt | 2025-2027 | Bashkëpunimi me OJQ dhe IEA | | | | | | |
| 1.2.2 | Koordinimi i punës së EPRBM-ve në shkolla | 2025-2029 | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.2.3 | Ofrimi i mbështetjes financiare për qendrat mësimore brenda Komunës | 2026-2029 | Grante për OJQ që menaxhojnë qendrat mësimore | | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 20,000 |
| | | | Subtotali 1.2 | | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 20,000 |
| **Masa 1.3** | Përmirësimi i kushteve të punës për FNV | | | | | | | | |
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 1.3.1 | Investime në infrastrukturë për përmirësimin e kushteve të punës të FNV | 2025-2027 | Planifikimet bëhen në bazë të nevojave | 5,000 | 5,000 | 5,000 | | | 15,000 |
| 1.3.2 | Investimi në mjete për punë me FNV | 2025-2028 | Planifikimet bëhen në bazë të nevojave | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | | 20,000 |
| 1.3.3 | Punësimi i numrit të mjaftueshëm të asistentëve për FNV | 2025-2028 | Pagat mbulohen nga Granti Specifik i Arsimit | | | | | | |
| 1.3.4 | Trajnime për punë me FNV | 2025-2027 | Mjetet ndahen nga buxheti për trajnime (Masa 3.2) - rreth 3,000 EUR/vit | | | | | | |
| 1.3.5 | Organizimi i aktiviteteve mbështetëse për prindërit në bashkëpunim me QPS | 2026-2028 | Shpenzime organizative | 500 | 500 | 500 | 500 | 500 | 2,500 |
| 1.3.6 | Shpenzimet e udhëtimit për FNV | 2025-2029 | | 30,000 | 30,000 | 30,000 | 30,000 | 30,000 | 150,000 |
| | | | Subtotali 1.3 | 40,500 | 40,500 | 40,500 | 35,500 | 30,500 | 187,500 |
| **Masa 1.4** | Rishikimi i profileve dhe i kuotave për regjistrim në AAP | | | | | | | | |
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 1.4.1 | Rishikimi i profileve dhe kuotave për regjistrim në arsimin e mesëm të lartë përmes dialogut me palët e interesit | 2025-2029 | Mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit për nxënësit nga Komuna e Obiliqit që regjistrohen në SHML në Prishtinë - 50 nxënës x 170 ditë pune x 2 eur = 17,000 EUR/vit | 17,000 | 17,000 | 17,000 | 17,000 | 17,000 | 85,000 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.4.2 | Lidhja e partneriteteve me bizneset lokale për kryerjen e punës praktike | 2025-2029 | | | | | | | |
| | | | Subtotali 1.4 | 17,000 | 17,000 | 17,000 | 17,000 | 17,000 | 85,000 |
| | | | **Totali Objektivi strategjik 1:** | 58,500 | 73,000 | 108,000 | 130,000 | 110,000 | 479,500 |

| **Objektivi strategjik 2:** | Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit në të gjitha shkollat e Komunës së Obiliqit përmes sigurimit të burimeve të nevojshme, ofrimit të mbështetjes për të gjithë nxënësit dhe fuqizimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Masa 2.1** | Sigurimi i mjeteve të konkretizimit për shkolla | | | | | | | | |
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 2.1.1 | Identifikimi i nevojave specifike të shkollave për mjete mësimore | 2025 | Ndihmë profesionale nga institucione të specializuara në fushën e arsimit | | | | | | - |
| 2.1.2 | Hartimi i listës së standardizuar të mjeteve mësimore | 2025 | Ndihmë profesionale nga institucione të specializuara në fushën e arsimit | | | | | | - |
| 2.1.3 | Hartimi i planit për blerjen dhe shpërndarjen e mjeteve të konkretizimit | 2025 | | | | | | | - |
| 2.1.4 | Furnizimi i shkollave me mjete të konkretizimit | 2026-2029 | | | 25,000 | 25,000 | 25,000 | 25,000 | 100,000 |
| 2.1.5 | Organizimi i takimeve dhe seminareve për shkëmbimin e përvojave | 2026-2029 | Mjetet ndahen nga buxheti për trajnime (Masa 3.2) - rreth 2,000 EUR/vit | | | | | | - |
| | | | Subtotali 2.1 | - | 25,000 | 25,000 | 25,000 | 25,000 | 100,000 |
| **Masa 2.2** | Fuqizimi i rolit të koordinatorëve të cilësisë në shkolla | | | | | | | | |
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.2.1 | Emërimi i koordinatorëve të cilësisë konform UA 24/2016 | 2025-2026 | Pagesa e koordinatorëve bëhet nga Granti Specifik i Arsimit | | | | | | - |
| 2.2.2 | Pjesëmarrja e koordinatorëve të cilësisë në trajnime | 2025-2029 | Trajnimet organizohet nga MASHTI ose ofertues të autorizuar | | | | | | - |
| 2.2.3 | Organizimi i konsultimeve me koordinatorë të cilësisë brenda komunës | 2025-2029 | | | | | | | - |
| | | | Subtotali 2.2 | - | - | - | - | - | - |

| **Masa 2.3** | Rishikimi i rrjetit të shkollave dhe paraleleve të ndara me qëllim të ngritjes së cilsësisë së mësimit | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 2.3.1 | Analiza e gjendjes aktuale të rrjetit të shkollave dhe trendeve demografike | 2025 | Konsulencë profesionale | 1,000 | | | | | 1,000 |
| 2.3.2 | Hartimi i planit për riorganizimin e rrjetit të shkollavenë Komunë | 2025 | | | | | | | - |
| 2.3.3 | Konsultimet me komunitetin rreth planit për riorganizimin e rrjettit të shkollave në komunë | 2026 | | | | | | | - |
| 2.3.4 | Aprovimi dhe zbatimi i planit për riorganizimin e rrjetit të shkollave | 2026-2029 | | | | | | | - |
| 2.3.5 | Kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit për nxënësit e SHFMU dhe SHML brenda Komunës | 2025-2029 | 714 nxënës x 135 euro/vit | 96,390 | 96,390 | 96,390 | 96,390 | 96,390 | 481,950 |
| 2.3.6 | Bartja e nxënësve të SHMFU në zonën e interesit nacional (Shipitullë-Graboc i Epërm, Hade, Palaj) dhe Lagjaja Mavriqi-Hade e Re | 2025-2029 | | 20,000 | 20,000 | 20,000 | 20,000 | 20,000 | 100,000 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.3.7 | Bartja e nxënësve me kombibus të KK-së (Babimoc-Millshevë-Njanavod-Palaj) | 2025-2029 | | 20,000 | 20,000 | 20,000 | 20,000 | 20,000 | 100,000 |
| | | | Subtotali 2.3 | 137,390 | 136,390 | 136,390 | 136,390 | 136,390 | 682,950 |
| **Masa 2.4** | Organizimi i mësimit plotësues dhe shtues | | | | | | | | |
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 2.4.1 | Organizimi i mësimit plotësues në shkolla | 2025-2029 | | | | | | | - |
| 2.4.2 | Përgatitja e nxënësve për gara komunale dhe republikane | 2025-2029 | Shpenzimet për përgatitjen e nxënësve | 1,500 | 2,000 | 2,500 | 3,000 | 3,000 | 12,000 |
| 2.4.3 | Përgatitja e nxënësve për testin e arrtishmërisë dhe provimin e maturës | 2025-2029 | Shpenzimet për përgatitjen e nxënësve | 500 | 500 | 500 | 500 | 500 | 2,500 |
| | | | Subtotali 2.4 | 2,000 | 2,500 | 3,000 | 3,500 | 3,500 | 14,500 |
| **Masa 2.5** | Organizimi i punës praktike dhe praktikës profesionale për nxënësit e AAP | | | | | | | | |
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 2.5.1 | Sigurimi i pajisjeve dhe materialit shpenzues për punën praktike në shkollë | 2025-2029 | Planifikimi bëhet sipas nevojave | 25,000 | 25,000 | 25,000 | 25,000 | 25,000 | 125,000 |
| 2.5.2 | Punësimi i instruktorëve të kualifikuar në SHMLP | 2026-2027 | Instruktorët paguhen nga Granti Specifik i Arsimit | | | | | | - |
| 2.5.3 | Lidhja e marrëveshjeve për kryerjen e praktikës profesionale në kompanitë lokale | 2025-2029 | | | | | | | - |
| | | | Subtotali 2.5 | 25,000 | 25,000 | 25,000 | 25,000 | 25,000 | 125,000 |
| **Masa 2.6** | Stimulime për mësimdhënësit, nxënësit e dalluar dhe studentët | | | | | | | | |
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 2.6.1 | Ndarja e cmimit "Mësimdhënësi i dalluar" | 2025-2029 | | 1,500 | 1,500 | 1,500 | 1,500 | 1,500 | 7,500 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.6.2 | Bursat për nxënës me sukses të shkëlqyeshëm | 2025-2029 | | 15,000 | 15,000 | 15,000 | 15,000 | 15,000 | 75,000 |
| 2.6.3 | Bursat për studentë të nivelit baçelor | 2025-2029 | | 115,000 | 115,000 | 115,000 | 115,000 | 115,000 | 575,000 |
| 2.6.4 | Bursat për studentë të nivelit master | 2025-2029 | | 51,000 | 51,000 | 51,000 | 51,000 | 51,000 | 255,000 |
| 2.6.5 | Bursat për studentë të nivelit të doktoratës | 2025-2029 | | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 25,000 |
| 2.6.6 | Çmimi "Adem Preniqi" për studentin më të dalluar | 2025-2029 | | 1,500 | 1,500 | 1,500 | 1,500 | 1,500 | 7,500 |
| Subtotali 2.6 | | | | 189,000 | 189,000 | 189,000 | 189,000 | 189,000 | 945,000 |
| | | | **Totali Objektivi strategjik 2:** | 353,390 | 377,890 | 378,390 | 378,890 | 378,890 | 1,867,450 |

| **Objektivi strategjik 3:** | Rritja e kapaciteteve profesionale të mësimdhënësve në Komunën e Obiliqit për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënit | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Masa 3.1** | Analiza e nevojave për trajnime | | | | | | | | |
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 3.1.1 | Hartimi i një analize gjithëpërfshirëse të nevojave për trajnime | 2025 dhe 2028 | Ndihmë profesionale nga institucione të specializuara në fushën e arsimit. Shpenzimet dedikohen për takimet e Grupit të Punës. | 500 | | | 500 | | 1,000 |
| | | | Subtotali 3.1 | 500 | | | 500 | | 1,000 |
| **Masa 3.2** | Ofrimi i mundësive për trajnimin e personelit mësimor | | | | | | | | |
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 3.2.1 | Emërimi i zyrtarit përgjegjës për zhvillimin profesional të mësimdhënësve në DKA | 2025 | | | | | | | - |
| 3.2.2 | Hartimi i planit për trajnime në bazë të analizës së nevojave | 2025 | | | | | | | - |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3.2.3 | Organizimi i trajnimeve për mësimdhënës | 2025-2029 | Planifikimi bëhet në pajtim me nevojat | 16,500 | 16,500 | 16,500 | 16,500 | 16,500 | 82,500 |
| | | | Subtotali 3.2 | 16,500 | 16,500 | 16,500 | 16,500 | 16,500 | 82,500 |
| **Masa 3.3** | Organizimi i rrjeteve të mësimdhënësve sipas fushave kurrikulare | | | | | | | | |
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 3.3.1 | Fuqizimi i aktiveve profesionale në nivel të shkollave | 2025-2027 | | | | | | | - |
| 3.3.2 | Formimi i aktiveve profesionale sipas fushave kurrikulare në nivel të komunës | 2026-2029 | Shpenzimet për takimet e aktiveve profesionale | 500 | 500 | 500 | 500 | 500 | 2,500 |
| 3.3.3 | Ofrimi i mundësive për shkëmbimin e përvojave në mes të mësimdhënësve të shkollave të ndryshme | 2026-2029 | Shpenzimet për takimet e mësimdhënësve | 500 | 500 | 500 | 500 | 500 | 2,500 |
| | | | Subtotali 3.3 | 1,000 | 1,000 | 1,000 | 1,000 | 1,000 | 5,000 |
| | | | **Totali Objektivi strategjik 3:** | 18,000 | 17,500 | 17,500 | 18,000 | 17,500 | 88,500 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi strategjik 4:** | Ngritje e efikasitetit dhe efektivitetit në menaxhim nëpërmjet forcimit të transparencës, llogaridhënies dhe bashkëpunimit | | | | | | | | |
| **Masa 4.1** | Fuqizimi i këshillave drejtues dhe organeve të tjera të shkollës | | | | | | | | |
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 4.1.1 | Funksionalizimi i këshillave drejtues dhe organeve të tjera të shkollës | 2025-2026 | | | | | | | |
| 4.1.2 | Përcjellja e punës së këshillave drejtues dhe organeve të tjera të shkollës nga DKA | 2025-2029 | | | | | | | |
| | | | Subtotali 4.1 | | | | | | |
| **Masa 4.2** | Ofrimi i mundësve për zhvillimin profesional të personelit menaxhues dhe personelit mësimor që synojnë poste menaxheriale | | | | | | | | |
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 4.2.1 | Organizimi i trajnimeve bazike për udhëheqje shkollore | 2025 dhe 2028 | 10 kandidatë x 350 EUR<br>Mjetet janë nga buxheti për trajnime (Masa 3.2) - 3,500 EUR për vitin 2025 dhe 2028 | | | | | | |
| 4.2.2 | Organizimi i trajnimeve të avancuara për udhëheqjen shkollore aktuale | 2026 dhe 2029 | Mjetet janë nga buxheti për trajnime (Masa 3.2) - 3,000 EUR për vitin 2026 dhe 2029 | | | | | | |
| | | | Subtotali 4.2 | | | | | | |
| **Masa 4.3** | Stimulime për performancën e drejtorëve të shkollave | | | | | | | | |
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 4.3.1 | Institucionalizimi i çmimit "Drejtori/-esha i/e vitit" dhe mirënjohjeve për udhëheqjen shkollore | 2025 | | | | | | | |
| 4.3.2 | Ndarja e çmimit "Drejtori/-esha i/e vitit" dhe mirënjohjeve për | 2026-2029 | Buxheti për çmime | 1,500 | 1,500 | 1,500 | 1,500 | 1,500 | 7,500 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | udhëheqjen shkollore | | | | | | | | |
| | | | Subtotali 4.3 | 1,500 | 1,500 | 1,500 | 1,500 | 1,500 | 7,500 |
| **Masa 4.4** | Ndërtimi i strukturës për menaxhim efektiv të arsimit në DKA | | | | | | | | |
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 4.4.1 | Rishikimi funksional i strukturës menaxhuese në DKA | | | | | | | | |
| 4.4.2 | Punësimi i personelit të ri dhe ripërcaktimi i përgjegjësive dhe detyrave të personelit aktual | 2025 | | | | | | | |
| 4.4.3 | Vlerësimi i performancës së personelit të DKA | 2026-2027 | | | | | | | |
| | | | Subtotali 4.4 | | | | | | |
| **Masa 4.5** | Nxitja e bashkëpunimit në mes të shkollave, komunitetit, OJQ-ve dhe bizneseve lokale | | | | | | | | |
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Totali |
| 4.5.1 | Organizimi i eventeve të përbashkëta me komunitetin, OJQ-të dhe bizneset lokale | 2025-2029 | Shpenzime për organizimin e eventeve | 1,000 | 1,000 | 1,000 | 1,000 | 1,000 | 5,000 |
| 4.5.2 | Ndihmë shkollave për lidhjen e partneriteteve strategjike me OJQ-të dhe bizneset lokale | 2025-2029 | | | | | | | |
| | | | Subtotali 4.5 | 1,000 | 1,000 | 1,000 | 1,000 | 1,000 | 5,000 |
| | | | **Totali Objektivi strategjik 4:** | 2,500 | 2,500 | 2,500 | 2,500 | 2,500 | 12,500 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi strategjik 5:** | Sigurimi i mjediseve shkollore të përshtatshme, të sigurta dhe të pajisura me teknologji sipas normave dhe standardeve që mundësojnë mësim cilësor | | | | | | | | |
| **Masa 5.1** | Evidentimi i nevojave për përmirësime në infrastrukturë dhe planifikimi i investimeve | | | | | | | | |
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Total |
| 5.1.1 | Planifikimi i investimeve të reja në infrastrukturën shkollore | 2025 | | | | | | | |
| 5.1.2 | Ndërtimi i objekteve të reja shkollore | 2026-2029 | Shpenzimet sipas planifikimeve | | 500,000 | 700,000 | | | 1,200, |
| 5.1.3 | Renovimi i objektive shkollore ekzistuese | | Shpenzimet sipas planifikimeve | | 100,000 | 50,000 | 50,000 | 50,000 | 250, |
| | | | Subtotali 5.1 | | 600,000 | 750,000 | 50,000 | 50,000 | 1,450, |
| **Masa 5.2** | Furnizimi i bibliotekave shkollore me libra | | | | | | | | |
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Total |
| 5.2.1 | Hartimi i planit për furnizimin e bibliotekave shkollore me libra | 2025 | | | | | | | |
| 5.2.2 | Blerja e librave për bibliotekat shkollore sipas planit | 2026-2027 | Shpenzimet sipas planifikimeve | | 20,000 | 20,000 | | | 40, |
| 5.2.3 | Katalogimi elektronik i librave në biblioteka shkollore | 2026-2029 | Blerja e një softueri për katalogim elektronik | | 1,000 | | | | 1, |
| 5.2.4 | Organizimi i aksionit për dhurimin e librave në shkolla | 2026-2027 | | | | | | | |
| | | | Subtotali 5.2 | | 21,000 | 20,000 | | | 41, |
| **Masa 5.3** | Identifikimi, parandalimi dhe raportimi i dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit | | | | | | | | |
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Total |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.3.1 | Formimi i ekipeve për parandalimin e dhunës dhe bullizmit në shkolla | 2025 | Ndihmë profesionale nga institucione të specializuara në fushën e arsimit. Shpenzimet dedikohen për takimet e Grupit të Punës. | | | | | | |
| 5.3.2 | Trajnimi i ekipeve për parandalimin e dhunës dhe bullizmit në shkolla | 2025-2027 | Shpenzimet e trajnimit mbulohen nga donacionet | | | | | | |
| 5.3.3 | Zgjidhja e konflikteve në mes të bashkëmoshatarëve përmes ndërmjetësimit | 2026-2029 | | | | | | | |
| 5.3.4 | Raportimi i rasteve të dhunës | 2025-2029 | | | | | | | |
| | | | Subtotali 5.3 | | | | | | |

| **Masa 5.4** | Mirëmbajtja e vazhdueshme e hapësirave arsimore | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Total |
| 5.4.1 | Sigurimi i mjeteve dhe materialeve të nevojshme për mirëmbajtjen e higjienës | 2025-2029 | Shpenzimet për materiale higjienike sipas nevojës | 15,000 | 15,000 | 15,000 | 15,000 | 15,000 | 75, |
| 5.4.2 | Mbikëqyrja e rregullt e higjienës në shkolla | 2025-2029 | | | | | | | |
| 5.4.3 | Institucionalizimi i çmimit "Shkolla më e pastër" dhe "Klasa më e pastër" | 2025 | | | | | | | |
| 5.4.4 | Ndarja e çmimit "Shkolla më e pastër" dhe "Klasa më e pastër" | 2026-2029 | Buxheti për çmime | 2,500 | 2,500 | 2,500 | 2,500 | 2,500 | 12, |
| 5.4.5 | Blerja e makinave për pastrim për shkolla | 2025 | 5 makina pastrimi x 2,000 EUR | 10,000 | | | | | 10, |
| | | | Subtotali 5.4 | 27,500 | 17,500 | 17,500 | 17,500 | 17,500 | 97, |

| **Masa 5.5** | Sigurimi i qasjes në internet dhe ndërtimi i rrjeteve lokale në të gjitha shkollat | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Total |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.5.1 | Vlerësimi i fizibilitetit për instalimin e LAN në të gjitha objektet shkollore | 2025 | 18 objekte shkollore x 500 eur/objekt | 9,000 | | | | | 9, |
| 5.5.2 | Instalimi i rrjeteve lokale (LAN) në objekte shkollore | 2025-2026 | 10 objekte shkollore x 20,000 EUR/objekt | 80,000 | 120,000 | | | | 200, |
| 5.5.3 | Sigurimi i qasjes në internet broadband | 2025-2029 | 5 shkolla x 4,000 EUR/vit<br>Të tjerat mbulohet nga Ministria e Ekonomisë | | 20,000 | 20,000 | 20,000 | 20,000 | 80, |
| | | | Subtotali 5.5 | 89,000 | 140,000 | 20,000 | 20,000 | 20,000 | 289, |
| **Masa 5.6** | Sigurimi i pajisjeve digjitale për shkollat | | | | | | | | |
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Total |
| 5.6.1 | Analiza e nevojave për pajisje digjitale në shkolla dhe hartimi i planit për furnizimin e shkollave me pajisje digjitale | 2025 | | | | | | | |
| 5.6.2 | Pajisja e të gjitha klasave me kompjutera dhe projektorë | 2025-2027 | 180 klasa x 1,000 EUR (1 kompjuter + 1 projektor) = 180,000 EUR<br>Gjysma e kësaj shume mund të shfrytëzohet nga burimet jashtë komunës - MASHTI, etj. | 20,000 | 30,000 | 40,000 | | | 90, |
| 5.6.3 | Pajisja e të gjitha objekteve shkollore me kabinete të kompjuterave | 2026-2029 | 18 objekte shkollore x 20 kompjutera (mesatarja) x 600 EUR = 216,000 EUR<br>100,000 - kontributi i komunës, të tjerat nga MASHTI | | 25,000 | 25,000 | 25,000 | 25,000 | 100, |
| 5.6.4 | Aksesorë për kompjutera | 2025-2029 | Printera rrjeti me fotokopjues - 18 objekte shkollore x 2 printera (mesatarja) = 36 printer x 5,000 = 180,000<br>Aksesorë të tjerë - 20,000 EUR<br>100,000 - kontributi i komunës, të tjerat nga MASHTI | 20,000 | 20,000 | 20,000 | 20,000 | 20,000 | 100, |
| | | | Subtotali 5.6 | 40,000 | 75,000 | 85,000 | 45,000 | 45,000 | 290, |

| Masa 5.7 | Krijimi i klubeve të nxënësve për mirëmbajtje bazike të pajisjeve digjitale nëpër shkolla | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kodi | Veprimet | Periudha e zbatimit | Burimet e nevojshme | Buxheti | | | | | |
| | | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | Total |
| 5.7.1 | Formimi i klubeve të nxënësve për mirëmbajtje të pajisjeve digjitale | 2025-2029 | Buxheti për funksionimin e klubeve | 1,500 | 1,500 | 1,500 | 1,500 | 1,500 | 7, |
| 5.7.2 | Trajnimi i klubeve të nxënësve për mirëmbajtje të pajisjeve digjitale | 2025-2027 | Pagesa për trajnerë | 1,000 | 1,000 | 1,000 | | | 3, |
| | | | Subtotali 5.7 | 2,500 | 2,500 | 2,500 | 1,500 | 1,500 | 10, |
| | | | **Totali Objektivi strategjik 5:** | 159,000 | 856,000 | 895,000 | 134,000 | 134,000 | 2,178, |

# 5. Korniza për monitorimin e PZHKA

Monitorimi i Planit Zhvillimor Komunal të Arsimit është pjesë përbërëse e zbatimit të tij dhe do të bëhet, nga Drejtoria Komunale e Arsimit. Monitorimi do të përqendrohet në dy fusha:

1. *Monitorimi i masave* ka të bëjë me përcjelljen e zbatimit të masave që parashihen me PZHKA. Si bazë për monitorim shërben plani i veprimit i dhënë në kapitullin 4, si dhe përshkrimet e aktiviteteve të dhëna në kapitullin 3. Ky lloj monitorimi do të organizohet nga drejtori i DKA për të kuptuar nëse aktivitetet zbatohen ashtu si janë planifikuar dhe sipas kalendarit të paracaktuar, si dhe nëse zbatimi i aktiviteteve kërkon burime që nuk janë paraparë me PZHKA. Të dhënat për monitorimin e aktiviteteve do të mblidhen nga raportet e shkruara, takimet e rregullta brenda DKA dhe, sipas nevojës, mbledhja e informatave nga palët e treta. Rekomandohet që monitorimi të bëhet dy herë brenda vitit.

Monitorimi do të jetë më i lehtë nëse për secilin aktivitet, gjatë një periudhe raportuese përcaktohen disa pyetje orientuese për të cilat kërkohet përgjigje. Në tabelën 8 është dhënë shembulli i pyetjeve orientuese për masën 1.1 - "Rritja e përfshirjes në EFH". Kjo masë ngërthen në vete aktivitete që kanë të bëjnë me ndërtimin e infrastrukturës (1.1.1), organizimin e fushatave të sensibilizimit (1.1.2), subvencionim të regjistrimit në kopshte private (1.1.3), adaptim të klasave në shkollat fillore ekzistuese për EFH (1.1.4 dhe 1.1.5) dhe mbështetje të OJQ-ve që ofrojnë forma alternative të EFH (1.1.6).

Pyetjet orientuese kanë për qëllim të lehtësojnë raportimin dhe ato duhet t'i përshtaten situatës. Në parim, këto pyetje duhet të hartohen pasi të jetë e qartë se çfarë është realizuar në periudhën monitoruese paraprake dhe çfarë ka mbetur pa u realizuar.

Tabela 8. Shembull i pyetjeve orientuese për Masën 1.1. ("Rritja e përfshirjes në EFH")

| Periudha monitoruese | Pyetjet orientuese |
|---|---|
| 1 janar-30 qershor 2025 | • A janë bërë përgatitjet e duhura për regjistrimin e fëmijëve në objektet e reja parashkollore?<br>• A është bërë planifikimi i fushatës sensibilizuese?<br>• A janë siguruar mjetet buxhetore për punësimin e personelit në objektet e reja parashkollore? |
| 1 korrik-31 dhjetor 2025 | • Sa efektive ka qenë fushata sensibilizuese për regjistrim në EFH? Sa fëmijë janë regjistruar?<br>• Çfarë lloj probleme janë shfaqur pas fillimit të punës të objekteve të reja parashkollore? |
| 1 janar-30 qershor 2026 | • Pyetjet orientuese për dy objektet e reja parashkollore formulohen varësisht nga zhvillimet në vitin 2025<br>• A janë bërë përgatitjet e duhura për subvencionimin e regjistrimit të fëmijëve në kopshte private? |
| 1 korrik-31 dhjetor 2026 | • Sa fëmijë janë regjistruar në kopshte private me subvencionim të Komunës? |
| 1 janar-30 qershor 2027 | • Pyetjet orientuese për regjistrimin e subvencionuar në kopshte private formulohen varësisht nga zhvillimet në periudhën monitoruese të fundit<br>• A është hartuar plani për adaptimin e 5 klasave të para në objektet ekzistuese për fëmijët e moshës 4 vjeç?<br>• A janë siguruar mjetet për punësimin e 2-3 edukatoreve për fëmijët 4 vjeç? |
| 1 korrik-31 | ... |

| | |
|---|---|
| dhjetor 2027 | |
| 1 janar-30 qershor 2028 | ... |
| 1 korrik-31 dhjetor 2028 | ... |
| 1 janar-30 qershor 2029 | ... |
| 1 korrik-31 dhjetor 2029 | ... |

2. *Monitorimi i objektivave strategjike* bazohet në përcjelljen e arritjes së treguesve të suksesit cilët duhet definuar. Për shembull, disa tregues për objektivin 1 – "Përmirësimi i përfshirjes në edukim dhe arsim për të gjitha grupet shoqërore" – mund të jenë:

- Numri i fëmijëve të përfshirë në forma të ndryshme të edukimit në fëmijërinë e hershme (kopshte publike, klasa parafillore, kopshte private me subvencionim, forma alternative të EFH, etj.);
- Numri i fëmijëve me nevoja të veçanta të përfshirë në procesin arsimor;
- Shkalla e braktisjes së arsimit të detyrueshëm;
- Përqindja e nxënësve në shkollat e mesme profesionale.

Treguesit mund të identifikohen me rastin e planifikimit për vitin vijues, duke përcaktuar edhe caqe aty ku është e mundshme, p.sh. presim të paktën 200 fëmijë të regjistrohen në kopshte publike deri në fund të vitit 2025, shkalla e braktisjes të jetë më e vogël se 0.1% e kështu me radhë.

Raportet e monitorimit do të hartohen në fund të vitit dhe do të përfshinë në vete të dhëna për monitorimin e aktiviteteve dhe të objektivave. Raportet e tilla do të përfundojnë me rekomandime të cilat duhet të merren parasysh me rastin e planifikimit të veprimeve për periudhat vijuese të zbatimit të PZHKA. Nga analiza e raporteve të monitorimit mund të rrjedhë nevoja për rishikimin e PZHKA dhe të hapave për implementimin e tij.

Ky Plan hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të MAPL-së dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

Komuna Obiliq

Kryesuesja e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiqi Kabashi

# Shtojcë 1: Harta e institucioneve arsimore në Komunën e Obiliqit

- ● Institucion parashkollor
- ▬ SHFMU Amë
- ▭ SHFMU Paralele e ndarë
- ▲ SHML Amë
- △ SHML Paralele e ndarë



# Shtojcë 2: Pjesëmarrësit në procesin e planifikimit

1. Fitore Hashani,drejtoreshë në Drejtorinë e Arsimit (DA),Komuna e Obiliqit
2. Rexhep Zeka,shef për arsimin fillor dhe të mesëm në DA,kryetar i ekipit për hartimin të PZHKA (EHPZHKA)
3. Fatime Pllana, shefe në sektorin e arsimit në DA,anëtare e EHPZHKA
4. Agim Preniqi, Zyrtar zotues në DA,anëtar i EHPZHKA
5. Dukagjin Pupovci, konsulent, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), Prishtinë
6. Shyhrete Gashi, drejtoreshë në SHFMU "Dr. Ibrahim Rugova", Obiliq,anëtare e EHPZHKA
7. Urim Grajqevci, zyrtar në DA,anëtar i EHPZHK
8. Bejtë Çela, mësimdhënës e koordinator i cilësisë në SHMLP"Ismail Dumoshi",anëtar i EHPZHKA
9. Bashkim Imailj, drejtor në SHFMU"Migjeni ",Siboc,anëtar i EHPZHKA
10. Elfete Gërguri, drejtoreshë në IP"Rrita jonë " , Obiliq ,Grupi Punues-GP
11. Besa Gashi Dvorani, drejtoreshë në Gjimnazin "17 Shkurti ", Obiliq,GP
12. Ragbeta Gashi, drejtoreshë në SHFMU"Naim Frashëri",Breznicë ,GP
13. Mevlude Grajqevci, drejtoreshë në SHFMU"Fazli Grajqevci ",Hade ,GP
14. Ismail Shalaku, drejtor në SHFMU"Abdurrahmon Gërguri", Dardhishtë,GP
15. Naser Abazi, drejtor në SHFMU"Hasan Prishtina ", Milloshevë ,GP
16. Naim Shabani, kryetar i Këshillit të Prindërve Komunal,GP
17. Faton Beka, kryesues i Komitetit për Kominitete në KK Obiliq,GP
18. Fatime Halimi, ud.drejtore në Qendren për Punë Sociale ,Obilq,GP
19. Fitim Sadiku, sekretar, Kryqi i Kuq i Kosovës ,dega në Obiliq,GP
20. Eljesa Tërbunja, kryetar OJQ "HANDIKOS" ,dega në Obiliq,GP
21. Valentina Aliu,kryetare OJQ , Këshilli i Veprimit Rinor Lokal,Obiliq, KVRL,GP